



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimin Tematik të ushtruar në
“Bashkinë Peqin”

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR **AUDITIMIN TEMETIK**

“BASHKIA PEQIN”

**Auditim Financiar, mbi pasqyrat
financiare 2020**

Tiranë, 2021

📖 PËRMBAJTJA:

NR	EMËRTIMI I KAPITUJVE	FAQE
I	PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE	4 - 10
I.2	Konkluzioni dhe Opinioni Auditimit	10 - 11
II	HYRJA	11 - 15
	a. Titulli. b. Marrësi. c. Objektivat dhe qëllimi. d. Identifikimi i çështjes. e. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese. f. Përgjegjësitë e Audituesve. g. Kriteret e vlerësimit. h. Standardet e auditimit. i. Metodot e auditimi. j. Dokumenti i auditimit.	
III.	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	15 - 37
III/1	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim	15 - 16
III.1.	Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit.	16 - 37
	<i>A-Vlerësimi Raportimit Financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitet 2019-2020, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi dhe konkretisht, ligjin nr. 24/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe UMFE nr.08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”.</i>	
IV.	GJETJE DHE REKOMANDIMI	37 - 41

SHKURTIME

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit.
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli.
NA	Nëpunës Autorizues.
NZ	Nëpunës Zbatues.
GSM	Grupi i Menaxhimit Strategjik.
FZHR	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara.
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave.
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak.
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit.
INOTSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit.
ISA	Standardet Ndërkombëtare të Auditimit
IFAC	Federatës Ndërkombëtarë të Kontabilistëve
IPSAS	Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik
IT	Teknologjia e Informacionit.
NJA	Njësi Administrative.

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Në përputhje me objektin e auditimit, u auditua me zgjedhje mbi bazë materialiteti dhe risku, gjendja aktuale e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, monitorimi i tyre nga Auditimi i Brendshëm, planifikimi dhe zbatimi i buxhetit për të ardhurat dhe shpenzimet, mbajtja e kontabilitetit dhe hartimi i pasqyrave financiare, aplikimi i rregullave kontabël si dhe nëse transaksionet financiare janë në përputhje me kërkesat ligjore, rregullat e institucionit dhe parimet, për një qeverisje të mirë dhe transparente, në përmbushje të objektivave të institucionit Bashkia Peqin.

Për këto u analizuan pyetësorët e vetëvlerësimit, akt akordimet me thesarin duke shkarkuar transaksione financiare nga SIFQ¹, u krye analiza e posteve të bilancit dhe llogarive analitike me formatet shoqëruese të tyre duke prekur zonat e llogarive, si më poshtë:

Llogaria 520 “Disponilite në Thesar”; Llogaria 466 “Kreditorë për mjetet në ruajtje”; Llogaritë 230 dhe 231 “Investime...”; Llogaritë 202, 210, 211, 212, 213, 214, 215, 218, 31, 32, “Aktiveve të Qëndrueshme, Qarkulluese dhe të tjera Aktive”; Llogaria 202 “Studime dhe kërkime”; Llogaria 210 “Toka, troje, terrene”; Llogaria 211 “Pyje kullota plantacione”; Llogaria 212 “Ndërtesa e konstruksione”; Llogaria 213 “Rrugë rrjete vepra ujore”; Llogaria 214 “Instalime teknike, makineri paisje, vegla pune”; Llogaria 215 “Mjete transporti”; Llogaria 218 “Inventar ekonomik”; Llogaritë e Klasës 25/26 “Aktivet Afatgjata Financiare”; Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm”; Llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”; Llogaria 4342 “Operacione me shtetin”; Llogaria 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”; Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm”; Llogaria 42 “Detyrime ndaj personelit”; Llogaria 431 “Detyrimet ndaj shtetit për tatim taksat”; Llogaria “435 “Sigurime Shoqërore”; Llogaria “436 “Sigurimet shëndetësore”; llogaritja dhe paraqitja e amortizimit, etj. 600 “Paga”, 602 “Shpenzime operative” dhe 230-231 “Investime”.

- Nga auditimi i pasqyrave financiare (balance) të viti 2020, grupi i auditimit të KLSH, pas vlerësimit të dokumentacionit, arrin në konkluzionin për një **“opinion të kundërt”**, pasi disa nga llogaritë nuk paraqesin drejt në të gjitha aspektet materiale, pozicionin e llogarive në fund të periudhave ushtrimore, performancës financiare dhe fluksin e parasë në përputhje me kuadrin e Raportimit Financiar të Sektorit Publik.

I.1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca në Raport	Rekomandimi
1	Pasqyrat financiare të vitit 2020 (bilanci), janë mbyllur jashtë afatit ligjorë, konfirmuar me shkresën nr. 64 prot, datë 16.04.2021, që Bashkia Peqin ka paraqitur të konfirmuar nga Dega e Thesarit Peqin, përgatitjen e pasqyrave financiare	E lartë	16-37	Kryetari i Bashkisë, të analizojë shkaqet e mos mbylljes në afat të pasqyrave financiare të vitit 2020, duke evidentuar personat përgjegjës dhe të marrë masë ndaj tyre në zbatim të shkronjës (e) të nenit 71-Kundërvajtje

¹ Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësi a	Referenc a në Raport	Rekomandimi
	vjetore të vitit 2020 me anekset përkatëse, <u>pra me 1 muaj vonesë</u> . Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me shkronjën (d) e pikës 4 e nenit 9, dhe shkronjës (b) e pikës 2 të nenit 12, të ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollit”; UMF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësinë e Qeverisjes së Përgjithshme”, pika 118.			<i>administrative</i> , të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në R.SH”, ndryshuar me ligjin nr. 114/2012/datë 07.12.2012 dhe ligjin nr.57/2016, datë 2.6.2016. - Në pasqyrat financiare të përshkruhet qartë baza mbi të cilën janë përgatitur, duke referuar aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për klasifikimin dhe raportimin e pasqyrave financiare. Përgjegjësia për raportim në çdo kohë të jetë e dokumentuar jo nëpërmjet shkresës përcjellëse të dërgimit të pasqyrave, por evidentohet në përgjegjësi të plotë në kapakun e pasqyrave financiare, se kush janë hartuesit dhe drejtuesit.
2	Në pasqyrat Financiare të fund vitit 2020, disa llogari të aktivit, nuk pasqyrojnë saktë gjendjen debitorë ose ka llogari të cilat janë të denatyrizuar pasi nuk duhej të ishin me saldo debitor ose duhej të ishin mbyllur në fund të vitit ushtrimor pasi janë llogari të përkohshme, konkretisht: 1.-Llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” për vlerën kontabël 33,114,538 lekë. Kjo llogari është krijuar gjatë vitit 2020 dhe përfaqëson vlerën kundërparti të disa llogarive të detyrimeve kreditore të pasivit të bilancit, e analizuar si vijon: Sigurime Shoqërore e Shendetsore në vlerë 4,275,157 lekë , Tatim në burim në vlerë 11133 lekë, Shpërblim KB në vlerë 3,161,187 lekë, Paga Tetor në vlerë 7333179 lekë, Paga nëntor në vlerë 6999955 lekë dhe Paga Dhjetor në vlerë 11233721 lekë Vlera debitorë e kësaj llogarie, nuk është e kuadruar me shumën e llogarive kreditore të pasivit të bilancit, vlera e të cilave është në shumën totale 82,854,723 lekë sipas llogarive dhe as është e analizuar	E mesme	16-37	Drejtoria e Financës, të marrë masat për sistemimin e llogarive të sipër cituara, bazuar në dokumentacionin ligjor e kontabël; -Të bëjë sistemimin e llogarive kontabël përsa janë konstatuar diferenca më pak ose më shumë sesa aktet e rakordimet me Degën e Thesarit për gjendjen kontabël në fund të vitit ushtrimor 2020

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësi a	Referenc a në Raport	Rekomandimi
	sipas llojeve të detyrimeve të pa paguara si më poshtë vijon: -Llogaritë 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” për vlerën kontabël për 30,134,750 lekë dhe llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm” për vlerën kontabël 36,483,176 lekë. 2.-Në këtë rast, llogaria 520 “Disponibilitete në Thesar” e parakorduar me të dhënat e Degës së Thesarit, në pasqyrat financiare, nuk pasqyron saktë vlerën e saj në fund të vitit ushtrimor, pasqyruar më shumë në pasqyrat financiare për diferencën 32,832,865- 32,823,070 = 9,795 lekë, 3.-Po kështu llogaria 466 “Kreditorë për mjetet në ruajtje” në pasqyrat financiare është për vlerën kontabël 14,188,355 lekë. Sipas analizës së kësaj llogarie të rakorduar me degën e thesari, kjo llogari është për vlerën 14,174,863 lekë dhe është e analizuar sipas objekteve për 21 raste. Në këtë rast, vlera kontabël e kësaj llogarie, nuk është pasqyruar saktë, pasqyruar më shumë për diferencën (14,188,355- 14,174,863) = 13,492 lekë.			
3	Në pasqyrat financiare gjendja e llogarisë 466 “Kreditorë për mjetet në ruajtje” është për vlerën kontabël 14,188,355 lekë. Sipas analizës së kësaj llogarie të rakorduar me degën e thesari, kjo llogari është për vlerën 14,174,863 lekë dhe është e analizuar sipas objekteve për 21 raste. Në këtë rast, vlera kontabël e kësaj llogarie, nuk është pasqyruar saktë, pasqyruar më shumë për diferencën (14,188,355- 14,174,863) = 13,492 lekë. Nga analiza e përmbajtjes së kësaj llogarie, konstatohet se për 15 subjekte në shumën 6,806,832 lekë gjenden në ngurtësuar fonde nga vitin 2019 për të cilat është përmbushur afati i garancisë dhe	E lartë	16-37	Drejtoria e Financës, në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të saktësojnë subjektet dhe fondet për të cilat janë ngurtësuar si garanci për punimet e kryera për të cilat kanë humbur të drejtën e përfitimit të tyre ose që janë në kushtet e parashkrimit të së drejtës, në zbatim të kërkesave të pikës 10, Kap. II të UKM nr. 3, datë 15.02.2011 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar. Drejtoria e Financës, për këto raste, të procedojë sipas kërkesave ligjore pranë Degës së Thesarit Peqin për rimarrjen e fondeve të ngurtësuar dhe përdorimin e tyre

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësi a	Referenc a në Raport	Rekomandimi
	nuk është bërë çbllokimi i tyre. Drejtoria e Financës, nuk ka kryer asnjë veprim sipas kushteve të kontratës për ç'bllokimin e këtyre fondeve dhe përdorimin e tyre në buxhetin e vet. Përsa më sipër, <i>nuk janë zbatuar kërkesat</i> e UMF nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, Kap. III, pikat 29, 30, 39, 50 dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2011 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kap. II, pika 10.			në interes publik.
4	Gjendja e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”, në fillim të vitit 2020 është në vlerën historike 16,483,985 lekë dhe në fund të vitit 2019 në vlerën historike 16,483,985 lekë. Gjendja e kësaj llogari është e pa ndryshuar, pasi Drejtoria e Financës nuk ka rakorduar me Drejtorin e taksave mbi gjendjen e debitorëve në mbyllje të pasqyrave financiare për vitin 2020. Nga analiza e kësaj llogarie konstatohet se në debi të saj janë kontabilizuar debitorët për tatim taksat lokale të subjekteve për shumën 15,453,375 lekë kurse diferenca për shumën 1,030,610 lekë është vlera debitorë e subjektit sipërmarrës të punimeve “Leon Konstruksion” shpk sipas rekomandimeve të KLSH-së nga auditimi i kaluar. Nga Drejtoria e Financës dhe Drejtoria Juridike e Bashkisë Peqin, <i>nuk është procedura sipas ligjit përfshi kërkesë padi në Gjykatë për arkëtimin e detyrimeve debitorë, në kundërshtim me kërkesat ligjore.</i> Sipas rakordimet me Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit nuk janë përfshirë gjobat e vendosura nga IMTV-ja, në vlerën 3,500,000 lekë e akumuluar në fund të vitit ushtrimor 2020, kjo shuma nuk rezultojnë e	E lartë	16-37	- Drejtoria Ekonomike në Bashkinë Peqin të mbajë evidencën kontabël për të ardhurat dhe të kryejë veprimet kontabël për evidentimin e debitorëve për taksat dhe tarifat në llog. 468 “Debitorë të ndryshëm”, në mënyrë që përfshirja e të ardhurave në pasqyrat financiare të mos bëhet nga jashtë port ë ndjekë logjikën kontabël, duke i pozicionuar saktë në llogaritë përkatëse me qëllim që PF të ofrojnë një informacion të saktë mbi të drejta dhe detyrimet e të tretëve ndaj shtetit për taksa dhe tarifa vendore. - Drejtoria e Financës, në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, të marrë masat e nevojshme për arkëtimin e vlerave debitorë të krijuar në vite duke procedurë me kërkesë padi në Gjykatë, në zbatim të kërkesave ligjore si dhe kontabilizimin e gjobave të vendosura nga IMTV-ja në fund të vitit 2020 në vlerën 3,500,000 lekë

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësi a	Referenc a në Raport	Rekomandimi
	regjistruara në kontabilitet në llogarinë që debitohet në bilancin kontabël 468 “Debitorë të ndryshëm” dhe llogarinë që kreditohet në pasqyrën e performancës financiare “7115 “Gjoha kamatëvonesa, sekuestrime dhe zhdëmtime”. Pra kemi një nënvlerësim të llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” dhe llogarisë “7115 “Gjoha kamatëvonesa, sekuestrime dhe zhdëmtime” me 3,500,000 lekë për vitin 2020. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin 9228 datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” neni 5, 6, 7, 9 dhe 10, ligjin 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, urdhrin nr.64 datë 22.07.2014 “ Për shpallje të Standarteve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuar” dhe Standartit Kombëtar të Kontabilitetit nr.8 “Të ardhurat”, pika 8 e Standartit ku përcaktohet njohja fillestare e të ardhurës.			
5	Gjendja e llogarisë 202 “Studime dhe Kërkime” paraqitet në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 15,524,250 lekë. Vlera e mbetur në fund të vitit 2020 prej 15,524,250 lekë e aktiveve afatgjata jo materiale e paraqitur në gjendjen e llogarisë 202 “Studime dhe Kërkime”, për 18 projekt-studime për investime të kryera nuk është shpërndarë sipas llojit të aktiveve materiale, ku janë kryer investimet, pavarësisht se punimet kanë përfunduar në vitet e mëparshme. Në fakt këto shpenzime për projektimin e një investimi të kryer për krijimin apo rikonstruktionet e aktiveve afatgjata materiale ose AQT nuk duhet të kontabilizohet në llogarinë 202 “Studime dhe kërkime” pasi këto janë pjesë e kostos së AQT dhe nuk janë shpenzimet për kërkime të	E mesme	16-37	Drejtoria Ekonomike në Bashkinë Peqin të kryejë veprimet e sistemit në kontabilitet për shpërndarjen e vlerës së studim-projekttimeve sipas investimeve të kryera dhe për çdo lloj aktivi afatgjatë material si pjesë e kostos së tij, duke kredituar llog. 202 “Studime dhe Kërkime” dhe debituar llogaritë përkatëse të klasës 21 për vlerat e mbetura koresponduese, në mënyrë që aktivet sipas llojit të paraqiten në vlerë të plotë.

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësi a	Referenc a në Raport	Rekomandimi
	aplikuara dhe të zhvillimit. Për këtë vlerë ekziston inventar kontabël dhe fizik dhe ruajtja e tyre është bërë në arkiv në çdo dosje teknike të tenderave sipas investimit të kryer në aktivet materiale afatgjatë. Përsa trajtuar më sipër, këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzim e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik” Pika 2. Klasa 2, “Aktivet afatgjata” (përbërja dhe trajtimi kontabël), me VKM nr 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standarteve dhe rregullave kontabël”, Seksioni II “Aktivet e Qëndrueshme Patrupëzuar” Pika 1/b “Klasifikimi kontabël” e cila ndër të tjera përcakton se: “Shpenzimet e kërkimeve të aplikuar dhe të zhvillimit - Llogaria 202” .			
6	Gjendja kontabël e aktiveve afatgjata materiale (në vlerën bruto) për vitin 2020 në vlerën 3,416,476,817 lekë dhe për vitin 2019 në vlerën 3,322,706,852 lekë është paraqitur i plotë, pasi janë pasqyruar të gjitha shtesat dhe pakësimet për çdo lloj grup aktiv. Inventari kontabël i aktiveve materiale gjendje në llogaritë: 210 “Toka, Troje, Terrene” është në vlerën 5,612,083 lekë; 211 “Pyje, Plantacione” në vlerën 13,928,877 lekë, 212 “Ndërtesa Konstruksione” në vlerën 656,054,662 lekë; 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” në vlerën 2,604,675,358 lekë; 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” në vlerën 24,596,832 lekë nuk është i qartë në përcaktimet e emërtesave dhe vlerave të secilit aktiv artikull për artikull. Në Dega e Thesarit Peqin	E lartë	16-37	Drejtoria Ekonomike në Bashkinë Peqin të kryejë veprimet për krijimin dhe mbajtjen e një regjistri analitik aktivesh sipas formatit, ku duhet të përmbajë: datën e hyrjes ose marrjen në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendodhje, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, datën e daljes nga pronësia, në formë analitike.

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësi a	Referenc a në Raport	Rekomandimi
	<u>nuk është kërkuar regjistri aktiveve për regjistrimin në sistemin informatikë financiar të qeverisë (SIFQ).</u> Pra nuk ka një data basë me të dhënat aktiv për aktiv vetëm për Bashkinë Peqin, pra duke mos u kryer procesi i informatizimit të tyre. Kjo mënyrë evidentimi dhe proces inventarizimi, nuk jep informacion të saktë kontabël për çdo aktiv, duke mos “certifikuar” vlerat tek për tek të aktiveve, për të ofruar siguri të arsyeshme rreth vlerës fizike dhe kontabël të tyre, të njohura dhe regjistruara në pasqyrat financiare të njësisë. Këto veprime janë në kundërshtim me ne kundërshtim me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” kapitulli III, pika.			
7	Nga Bashkia Peqin, <i>nuk janë kryer procedurat për inventarizimin e të gjitha aktiveve afat gjata jo materiale dhe materiale të investuara në vite nga Bashkia Peqin dhe ato që me miratim të Këshillit të Ministrave, kanë kaluar në pronësi të kësaj bashkie, konkretisht për llogaritë (me kostot historike):</i> Llogaria 202 “ <i>Studime dhe kërkime</i> ” për 21,730,200 lekë. Llogaria 210 “ <i>Toka, troje, terrene</i> ” për 5,612,083 lekë. Llogaria 211 “ <i>Pyje kullota plantacione</i> ” për 13,928,877 lekë. Llogaria 212 “ <i>Ndërtime konstruksione</i> ” për 656,054,622 lekë. Llogaria 213 “ <i>Rrugë rrjete vepra ujore</i> ” për 2,604,675,358 lekë. Llogaria 214 “ <i>Instalime teknike, makineri pajisje, vegla pune</i> ” për 24,596,832 lekë. Llogaria 215 “ <i>Mjete transporti</i> ” për 30,210,580 lekë. -Nuk është përgatitur regjistri i pronave. -Nuk është bërë regjistrimi i	E lartë	16-37	Kryetari i Bashkisë, të marrë masat që me specialistë të fushës, të inventarizojë dhe saktësojë pronat sipas të dhënave të kontabilitetit, regjistrimin e pronave në pronësi të vet, të kaluara me VKM-të përkatëse, si dhe për krijimin e regjistrit të pronave, në zbatim të kërkesave të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar dhe ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar.

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësi a	Referenc a në Raport	Rekomandimi
	aktiveve në pronësi të Bashkisë. Përsa më sipër, mosveprimet janë në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, Kap. III, neni 9, pika 1.2 - Të drejtën dhe përgjegjësinë e pronësisë; Kap. VII, neni 23, pika 14 –Planifikimin, administrimin, zhvillimin dhe kontrollin e territorit, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj , UMF nr. 30, datë 27.12.2011“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar pikat 26, 27, 30 dhe 74, dhe UMF nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”. Kap III- Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në Njësitë e Qeverisjes së përgjithshme, pika .			
8	Llogaria 4342 “Të tjera operacione me shtetin (debitor datë 31.12.2020)” në aktiv të pasqyrave financiare (Formati nr.1), paraqitet në vlerën 0 lekë pozicionimi i kësaj llogarie është bërë në mënyrë të gabuar. Pasi kjo llogari përbëhet nga detyrimet afatshkurtra për muajin dhjetor 2019 të cilat trashëgohen në vitin 2020, e cila në analizë përfshin gjendjet e llogarive në pasivin e bilancit: llog.401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” për vlerën 30,134,750 lekë, llog.42 “Detyrime ndaj personelit” për vlerën 26,290,063 lekë, llog.431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa” për vlerën 677,405 lekë, llog.435 “Sigurime shoqërore” për vlerën 3,246,772 lekë, llog. 436 “Sigurime shëndetësore” për vlerën 443,959 lekë Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 6,	E lartë	16-37	Bashkia Peqin, nëpërmjet Nëpunësit Zbatues, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet të llogarisë 4342 Operacione me shtetin” dhe kundër partisë 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” për shumën 60,792,949 lekë për vitin 2020 Veprimet e sistemuese të bëhen me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2021.

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësi a	Referenc a në Raport	Rekomandimi
	neni 10 dhe 11, të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, ligjin nr. 25/2018 datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 32 e tij.			
9	Llogarisë 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” paraqitet në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 30,134,750 lekë, dhe në mbyllje të vitit 2019 në vlerën 10,511,789 lekë, ku diferenca prej 19,622,961 lekë përfaqëson detyrimeve ndaj të tretëve për fatura të palikujduara gjatë vitit ushtrimor 2020. Sipas analizës së gjendjes së kësaj llogarie rezulton se ajo përbëhet nga 7 fatura të palikujduara të krijuara gjatë vitit 2020 për mallra dhe shërbime në vlerën 1,235,440 lekë dhe nga 18 raste detyrimesh për investime në vlerën 12,898,165 lekë. Nga analiza e kësaj e këtyre llogarive, sipas dokumentacionit që na u paraqit, konstatohet se vlera 18,010,183 lekë duhet të kontabilizoheshin në llog. 467 “Kreditorë të ndryshëm” për detyrime të prapambetura ndaj të tretëve. Këto veprime janë në kundërshtim me, UMF nr.2 datë 06.02.2012 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit” pikën 62 dhe 102, me Udhëzimin nr.2 datë 09.01.2015, pika 6.1 “Vendimet gjyqësore”, me Udhëzim e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik” Pika 3.3/c.d “Trajtimi kontabël dhe funksioni i llogarive të	E lartë	16-37	Drejtoria e financës në mbyllje të vitit ushtrimor 2021 të kryhen veprimet e sistemimit në kontabilitet që detyrimet ndaj të tretëve të lindura nga vendimet gjyqësore të formës së prerë të pashlyera dhe kontratat e investimeve në vlerën 18,010,183 leke të pasqyrohen në gjendjen kreditore të llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm” të pasivit të bilancit.

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësi a	Referenc a në Raport	Rekomandimi
	të tretëve (klasa 4)”, me VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël” Kapitulli IV “Llogaritë e të tretëve, klasa 4” Seksioni I “Përbërja, klasifikimi dhe sqarime të përgjithshme” pika 2.			

I.2. Konkluzioni dhe Opinioni i Auditimit

Opinioni i auditimit mbi pasqyrat financiare

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Bashkisë Peqin, për vitin ushtrimor 2020 të cilat përfshijnë pasqyrat e pozicionit financiar, pasqyrat e performancës financiare, pasqyrat e ndryshimeve të aktiveve, pasqyrat e fluksit të mjeteve monetare dhe pasqyrat e shënimeve shpjeguese. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumatat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Opinion i kundërt² për pasqyrat financiare të vitit 2020.

Sipas opinionit tonë, pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, shprehim një opinion të kundërt për llogaritë vjetore të subjektit Bashkia Peqin duke arritur në përfundimin se anomali të apo rastet mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale dhe të përhapura, në llogaritë vjetore të vitit 2020”. .

Përgjegjësitë e Drejtuesve të Bashkisë Peqin:

Strukturat drejtuese të Bashkisë Peqin, janë përgjegjëse për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara (*kriteret e vlerësimit*). Ato janë përgjegjëse për zbatimin e gjithë kuadrit rregullativ në prokurimin e fondeve publike. Gjithashtu, strukturat drejtuese të Bashkisë Peqin janë përgjegjëse funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, që ka rezultuar i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare, për të shmangur gabimet apo mashtrimet. Stafi drejtues është gjithashtu përgjegjës Personat përgjegjës për drejtimin janë përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit financiar.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH-së:

Objekti i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme, nëse pasqyrat financiare në tërësi, nuk paraqesin anomali materiale, kështu si pasaktësi apo gabime që mund të kenë ekzistuar, nëse veprimtaria e subjektit të audituar është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që

²**Opinion i kundërt.** Audituesi duhet të shprehë një opinion të kundërt: 1. kur audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomali të apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, të përhapura, në llogaritë vjetore apo transaksionet në fjalë; ose 2. kur audituesi nuk është në gjendje për të marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit ku të bazojë opinionin, dhe efektet e mundshme mbi llogaritë vjetore apo transaksionet të kësaj pamundësie janë materiale të përhapura.

përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH-së, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin e tij profesional në punën audituese.

Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale duke i përshkruar në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

II. HYRJË

II/1. PËRSHKRIM I AUDITIMIT.

Mbështetur në ligjin nr.154/14, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH”, në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr. 678, datë 14.06.2021 dhe autorizimit nr. 678/5, datë 14.6.2021 “Mbi auditimin e pasqyrave financiare viti 2020”, të miratuara nga Kryetari i KLSH, nga data 14.06.2021 – 02.07.2021, në subjektin **Bashkia Peqin** për periudhën e veprimtarisë nga 01.01.2020 – 31.12.2020, u krye auditimi “Auditim Financiar dhe Përputhshmërie” nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1. **K. GJ, Përgjegjës grupi**
2. **H. I, Auditues**

a- Titulli: Auditim financiar në Bashkinë Peqin .

b- Marrësi: Raporti Përfundimtar i Auditimit i drejtohet subjekti të audituar Bashkia Peqin.

c- Objektivat dhe qëllimi: Objektivi i auditimit financiar është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, nëse për vitin 2020, transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, kjo referuar kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi.

Qëllimi i auditimit të pasqyrave financiare është të rrisim shkallën e besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare, nëpërmjet shprehjes së një opinionit nga ana jonë nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar, si një mekanizëm kontrolli për të siguruar përgjegjshmërinë financiare.

Kjo përgjegjshmëri ka të bëjë drejtpërdrejt me menaxhimin e shëndoshë financiar si dhe me faktin që, rezultatet e përdorimi i burimeve janë të paraqitura drejt dhe në përputhshmëri me kornizën e raportimit financiar. Audituesit shtetërorë do të japin sigurinë ose jo nëse informacioni i paraqitur mbi shpenzimin e parave publike në programet publike përfaqëson në mënyrë të përshtatshme situatën financiare.

d- Identifikimi i çështjes: Të përcaktojë nivelin e duhur të materialitetit, duke i mundësuar kryerjen e saktë të auditimit (ISSAI 13), nëpërmjet një pune audituese sistematike me zgjedhje, duke saktësuar përputhshmërinë ligjore të akteve normative me qëllim që auditimi t'i shërbej subjektit në marrjen e masave në përmirësimin e punës në të ardhmen dhe për të bërë të mundur evidentimin në kohë të mangësive dhe shkeljeve për përmirësimin e gjendjes. Raporti i Auditimit, synon të identifikojë përmbushjen e rolit të njësisë vendore dhe përgjegjësitë të saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve dhe shërbimeve në dobi të komunitetit, në funksion të zbatimit të

strategjive që orientojnë zhvillimin e Bashkisë Peqin, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave dhe nevojave të tyre.

Saktësia, rregullshmëria, ndodhja e transaksioneve kontabël dhe regjistrimi i tyre me korrektësi dhe në përputhje me kuadrin e raportimit financiar në fuqi.

Në bazë të kriterëve të vlerësimit të gjykimit profesional, audituesit kanë bërë vlerësimin e rezultateve të testeve të kontrollit, analizimin dhe klasifikimin e gabimeve të zbuluara, si dhe është bërë vlerësimi i evidencave të grumbulluara përse i përket mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë për qëllimet e auditimit.

Nisur nga procedurat e ndjekura për auditim besojmë se evidencat e mbledhura janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të dhënë opinionin tonë mbi veprimtarinë ekonomiko-financiare të Bashkisë Peqin.

e- Përgjegjësitë e strukturave drejtuese: Administratori i Përgjithshëm, në cilësinë edhe të Nëpunësit Autorizues (NA) **L. T.** me detyrë Kryetar i Bashkisë Peqin dhe Drejtor i Financës, në cilësinë e Nëpunësit Zbatues (NZ) **H. M.**, janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm të raportimit financiar në sektorin publik dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare. Gjithashtu, në cilësinë edhe të NA si dhe NZ, janë përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Bashkisë Peqin, bazuar në ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, konkretisht neni 34, pika 6, neni 65, pika 1 dhe neni 91, pika 1.3.

f- Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH-së: Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion në lidhje me pasqyrat financiare Bashkisë Peqin dhe një opinion në lidhje me përputhshmërinë e aktivitetit të subjektit të audituar në lidhje me aktet ligjore dhe nënligjore për buxhetin, prokurimin dhe menaxhimin financiar dhe kontrollin. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI sipas INOTSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike dhe të planifikojë dhe kryejë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, sipas evidencës së mbledhur të auditimit.

Parimet e auditimit financiar: Në punën tonë audituese jemi mbështetur në parimet e mëposhtme:

- *Etika dhe pavarësia;*
- *Kontrolli i cilësisë*
- *Menaxhimi i grupit të auditimit dhe aftësive të tyre*
- *Parimet lidhur me konceptet bazë të auditimit.*

Pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim:

- *Përkatesia:* Transaksionet dhe ngjarjet që janë të regjistruara kanë ndodhur dhe i përkasin subjektit.
- *Plotësia:* Te gjitha transaksionet dhe ngjarjet që duhet të ishin regjistruar janë regjistruar
- *Saktësia:* Shumat dhe të dhëna të tjera lidhur me transaksionet e regjistruara dhe ngjarjet janë regjistruar në mënyrë të përshtatshme
- *Periudha:* Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në periudhën e saktë kontabël
- *Klasifikimi:* Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në llogaritë e duhura
- *Ligjshmëria dhe rregullsia:* Janë në përputhje me ndarjet buxhetore në dispozicion

Pohimet rreth gjendjeve të llogarive në fund të periudhës

- *Ekzistenca:* asetet, detyrimet dhe interesat e kapitalit neto ekzistojnë
- *Të drejtat dhe detyrimet:* Subjekti mban ose kontrollon të drejtat për asetet, detyrimet dhe janë obligimet e subjektit

- *Plotësia*: Të gjitha asetet, detyrimet dhe interesat e kapitalit neto që duhet të ishin regjistruar janë regjistruar

- *Vlerësimi dhe alokimi*: Aktivitet, pasivet dhe interesat e kapitali janë të përfshira në pasqyrat financiare dhe shumat përkatëse dhe ndonjë vlerësim ose alokim, rregullimet që rezultojnë janë të regjistruara.

Pohimet rreth prezantimit të shënimeve shpjeguese

- *Transaksionet*, të drejtat dhe detyrimet: Ngjarjet e shpalosura, transaksionet, si dhe çështje të tjera që kanë ndodhur i përkasin subjektit.

- *Plotësia*: Të gjitha informacionet shpjeguese që duhet të ishin përfshirë në pasqyrat financiare janë përfshirë.

- *Klasifikimi dhe kuptueshmëria*: Informacioni financiar është paraqitur në mënyrë të përshtatshme dhe të përshkruara dhe shënimet e kanë shprehur qartë.

- *Saktësia dhe vlerësimi*: Informacioni financiar dhe të tjera është dhënë në mënyrë të drejtë dhe në sasi të duhur.

g- Kriteret e vlerësimit: Auditimi u bazua në ligjin nr. 154/14, datë 27.11.14 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Manualin e Auditimit Financiar, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 196, datë 29.12.15, referenca të tjera ligjore dhe në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit sa më poshtë:

▪ **Në fushën e mbajtjes Kontabilitetit dhe Hartimit Pasqyrave Financiare**: Ligji nr. 9228, datë 24.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, i ndryshuar ligjin nr. 9477 datë 9.2.2006”, aktualisht i shfuqizuar; VKM nr. 248, datë 10.4.1998 “Për miratimin e planit kontabël publik, për organet e pushtetit lokal, institucionet shtetërore, qendrore dhe lokale, si dhe të njëjtit që varen prej tyre” i ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001; VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimi i standardeve dhe të rregullave kontabël”; VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiviteteve dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”; Udhëzimi i MF nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njëjtit të Qeverisjes së Përgjithshme”; Udhëzimi përbashkët i Ministrisë të Çështjeve Vendore dhe Ministrisë Financiare nr. 3237 datë 16.07.2015 “Për procedurat afatet kohore standardet dhe kriteret e plotësimit të dokumentacionit të nevojshëm për riorganizimin administrativo-territorial”.

h- Standardet e auditimit: ISSAI 100 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik”, i cili përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi; ISSAI 2000-2899 “Udhëzues të Auditimit Financiar”; ISSAI 2300 “Planifikimi i auditimit të pasqyrave financiare”; INTOSAI GOV 9100 “Udhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik” si dhe INTOSAI GOV 9110 “Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontroleve të brendshëm”. Standardet Kombëtare të Kontabilitetit; Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilistëve IFAC; Manuali i Auditimit Financiar dhe i Përputhshmërisë të KLSH-së; Manuali i Auditimit të Brendshëm, etj. Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC); Praktika të mira të fushës, si manualët e Gjykatës Evropiane të Audituesve, Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, etj.; Kodit Etik dhe Rregullores së Procedurave të Auditimit të KLSH.

i- Metodat e auditimit: Auditim i njëpasnjëshëm dhe me zgjedhje periudhash. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efikasitet dhe

efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Në gjykimin profesional të Audituesve të pavarur, për përzgjedhjen e kampioneve për ekzaminim, në zërat e shpenzimeve.

Vlerësimi bazuar në riskun dhe materialitetit³.

Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesit e vlerëson si të mundshëm për të influencuar të përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar.

Për arritjen e konkluzionit vlerësues, u përdorën teknikat e auditimit:

- Kontrolli aritmetik. Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim. (Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve)
- Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese. Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë asnjë gabim aritmetik, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje të pjesëve justifikuese (Urdhër shpenzimeve) konstatoi nëse shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar. UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.
- Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese. Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminon përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, duke u siguruar edhe për ekzistencën reale të aktiveve në subjekt.
- Kontrolli i vlerësimit. Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.
- Konfirmim nga të tretët. Nëse subjekti që auditohet ka të konfirmuara (Rakorduar) me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepërcave ose të çdo regjistrimi tjetër.
- Kontrolli sipas një treguesi. Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “jashtë normales”, që përbëjnë tregues të parregullsisë kontabël. Mund të përmendim: mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, të emrave, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave, etj.
- **Intervista**
- **Raporte dhe Informacione**
- **Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të Kontrollit të Brendshëm dhe MFK**

j- Dokumentimi i auditimit: Mbështetur në ISSAI 1315, objektivi i audituesit është identifikimi dhe vlerësimi i risqeve e anomalive materiale në pasqyrat financiare si edhe

³ **ISSAI 1320 (ISA 320)** trajtojnë përgjegjësinë e audituesit për të zbatuar konceptin e materialitetit në planifikimin dhe kryerjen e një auditimi të pasqyrave financiare, në funksion të zbulimit dhe korrigjimit të anomalive. Një trajtim i tillë i ngjashëm mund të përdoret edhe në rastet e auditimit të përputhshmërisë, ku natyrisht një rol të rëndësishëm ka gjykimi profesional i audituesit.

nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara të gabimeve materiale.

Në këtë kontekst merr rëndësi vlerësimi i materialitetit në përputhje me ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, i cili përcakton nivelin e gabimit që audituesi konsideron të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e pasqyrave financiare. Nisur nga gjykimi profesional i audituesit dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, grupi i auditimit përcaktoi materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar, ku si bazë për llogaritjen e tij janë marrë shpenzimet për pagat (600), shpenzimet operative (602) dhe investimet (231). Pas përcaktimit të nivelit të materialitetit, grupi i auditimit ka kryer vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në institucion sa i takon: (a) hartimit; (b) implementimit; dhe (c) funksionimit të 5 komponentëve të kontrollit të brendshëm. Vlerësimi i kontrollit të brendshëm është bazuar në kryerjen e testeve të kontrolleve. Gjatë kryerjes së testeve të kontrolleve është arritur në përfundimin që sistemet e kontrollit të brendshëm paraqesin risk të moderuar deri të lartë.

Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit, konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti. Kemi ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit. Informacion të vlefshëm administruam dhe nga procedurat e ndjekura nga vetë subjekti për vlerësimin e riskut, duke iu nënshtruar skepticizmit profesional nga ana e Audituesve. Gjatë vlerësimeve u mbështetëm në Modelin e Riskut që aplikon KLSH-ja⁴.

Procedurat e ndjekura nga grupi i auditimit konsistojnë në analizat e marrëdhënieve ndërmjet informacionit financiar dhe jo financiar; inspektimeve që konsistojnë në regjistrimin e dokumenteve në regjistra/ditarë/partitarë ose në trajtë elektronike por edhe në inspektime fizike; në kundërshtitë, të cilat kanë të bëjnë me analizën e proceseve dhe së fundmi, kërkimi/hetimi që konsiston në kërkimin e informacionit të personat kompetentë dhe të mirinformuar brenda dhe/ose jashtë njësisë shpenzuese.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT.

III/1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim:

Në përgatitjen e materialit dokumentar për planifikimin e auditimit, grupi i auditimit i është referuar auditimeve e kryera në periudhat e mëparshme, dokumentacionit të kërkuar subjektit, të dhënat e grumbulluara për demografinë, fondet e realizuara nga kjo njësi vendore të publikuara në faqen e Thesarit të Ministrisë së Financave dhe të APP për realizimin e prokurimit me fonde publike dhe të ardhurat e veta, aktivitetet kryesore dhe problematikat e trajtuara nga media, të realizuara këto nëpërmjet hulumtimeve dhe kërkimeve në internet dhe në median vizive.

Bashkia Peqin, është e organizuar dhe funksionon në bazë ligjit nr 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” dhe ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes Vendore”, Rregullorja mbi Organizimin dhe Funksionimin e Bashkisë Peqin etj. akt ligjore/nënligjore të nxjerra nga Këshilli Bashkiak Peqin.

⁴ Risku i Auditimit = Risku i qenësishëm * Risku i kontrollit * Risku i Zbulimit



Të dhëna të përgjithshme dhe pozicioni gjeografik:

Bashkia Peqin, bën pjesë në Qarkun e Elbasanit

Zona Gjeografike: Peqini kufizohet në veri me bashkinë Tiranë, në lindje me bashkinë Elbasan, në jug-lindje me bashkinë Cërrik, në jug-perëndim me bashkinë Lushnjë dhe në jug me bashkinë Belsh. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Peqinit.

Popullsia: Sipas Censurit të vitit 2011, Peqini ka një popullsi prej 26.136 banorësh. Ndërkohë që sipas Regjistrimit Civil, kjo bashki numëron 38.900 banorë. Bashkia e re shtrihet në një sipërfaqe prej 197.79 km² me një densitet prej 196.67 banorë/km² sipas regjistrimit civil dhe 132 banorë/km² sipas censurit.

Kjo bashki përbëhet nga 6 njësi administrative, të cilat janë: Peqin, Pajovë, Karinë, Përparim, Gjocaj dhe Shezë. Të gjitha njësitë administrative janë aktualisht pjesë e rrethit të Peqinit dhe qarkut të Elbasanit. Bashkia e re ka nën administrimin e saj një qytet dhe 50 fshatra.

Profili i bashkisë: Bashkia e re e Peqinit shtrihet përgjatë rrugës së vjetër Egnatia, ndërsa kalaja Klaudiana në qendër të qytetit është dëshmi e lashtësisë së këtij vendbanimi. Qyteti dhe të 50-të fshatrat e kësaj bashkie shtrihen në një zonë fushore dhe kodrinore.

Banorët e bashkisë së Peqinit janë të orientuar ndaj bujqësisë dhe vreshtarisë, por edhe mbarështimit të shpendëve. Kultivimi i ullinjve, i perimeve të serave dhe i produkteve të tjera bujqësore janë gjithashtu karakteristikë e zonës.

Peqini është i njohur për rritjen e gjelit të detit, mjaft i kërkuar në të gjithë Shqipërinë në kohë festash si dhe për sportin e ndeshjeve me gjela.

Bizneset janë kryesisht të përqendruar në shërbime, ndërkohë që në Peqin janë ngritur edhe disa punishte për vajin e ullirit.

Problemi më i madh i Peqinit është punësimi. Edhe pse një pjesë e mirë e banorëve merren me bujqësi, mundësitë ekonomike për ta janë të pakta. Sfidat e bashkisë së re janë të harmonizojë zonën urbane me zonën rurale si dhe hapja e bizneseve prodhuese, që mund t'i jepnin një hov punësimit të banorëve të Peqinit.

- Ndikimi i pandemisë COVID-19 në jetën ekonomike

Bashkia Peqin nuk ka përfituar ndihma ushqimore dhe ndihma pajisje inventari për shkak të COVID-19 dhe për pasojat e tërmetit të vitit 2020, nga donatorë të ndryshëm privat dhe shtetëror.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezultoi se për vitin 2020 Bashkia Peqin ka kryer 8 procedura prokurimi për situatën e COVID-19 në vlerën totale 5,455,458 lekë, për blerje ushqimesh për shtresa në nevojë dhe dezinfektim të kopshteve e shkollave, fonde këto të përdorura me procedurë prokurim.

III/2. Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të audimit.

Vlerësimi Raportimit Financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2020, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës

financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi dhe konkretisht, ligjin nr. 24/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” si dhe udhëzimi MFE nr.08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”.

Për vitin 2020 nga njësia shpenzuese “Aparati i Bashkisë Peqin” për hartimin e pasqyrave financiare dhe përgatitjen e llogarive vjetore është mbështetur në ligjin nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, të ndryshuar, Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, VKM nr.248, datë 10.04.1998 pika 3, ndryshuar me VKM nr.25, datë 20.01.2001, UMF nr.26, datë 27.12.2007 “Për disa shtesa e ndryshime në UMF nr.14, datë 28.12.2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore 2007, për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësive që varen prej tyre si dhe të njësive të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donator të huaj”, VKM Nr.783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël”. Lidhur me operacionet buxhetore, është rakorduar dhe konfirmuar nga Dega e Thesarit Peqin si dhe nuk ka patur në asnjë rast kontestime.

Pasqyrat financiare janë të firmosura nga NA dhe NZ si dhe janë të dërguara në Degën e Thesarit Peqin për vitin ushtrimor 2020 me shkresë përcjellëse nr. 597 prot., datë 30.03.2021. Në cilësinë e Nëpunësit Autorizues është Kryetari Bashkisë Peqin dhe në cilësinë e Nëpunësit Zbatues është Drejtori Ekonomik. Pra në këtë rast nuk ka delegime të këtyre detyrave.

1. Titulli i gjetjes: Nga auditimi u Konstatua se hartimi dhe plotësimi i pasqyrave financiare të vitit 2020 është bërë jashtë afatit ligjor.

Situata:

Pasqyrat financiare të vitit 2020 (bilanci), janë mbyllur jashtë afatit ligjorë, konfirmuar me shkresën nr. 64 prot, datë 16.04.2021, që Bashkia Peqin ka paraqitur të konfirmuar nga Dega e Thesarit Peqin, përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2020 me anekset përkatëse, pra me 1 muaj vonesë.

Kriteri:

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me shkronjën (d)⁵ e pikës 4 e nenit 9, dhe shkronjës (b)⁶ e pikës 2 të nenit 12, të ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollit”; UMF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësinë e Qeverisjes së Përgjithshme”, pika 118⁷.

Ndikimi/Efekti:

Mos hartimi në afat i pasqyrave financiare, krijon risk në drejtim të konfirmimit të pasqyrave financiare dhe mbivendosje të drejtimit në kontrollet e pasqyrave financiare.

Shkaku:

Mbingarkesa në kryerjen e detyrave funksionale dhe pamundësia për menaxhimin e situatës së konsolidimit.

Rëndësia: E lartë

⁵ Planifikimin, menaxhimin, kontabilitetin dhe raportimin financiar të veprimtarisë së njësive publike

⁶ raportimit periodik për vendimmarrjen, në funksion të realizimit të objektivave, si dhe të pasqyrave financiare vjetore të njësive publike, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi dhe rregullat e miratuara nga Ministri i Financave

⁷ Njësitë e qeverisjes vendore janë të detyruar të depozitojnë pasqyrat financiare vjetore të ushtrimit të mbyllur brenda muajt mars të vitit pasardhës.

Rekomandimi:

1. Kryetari i Bashkisë, të analizojë shkaqet e mos mbylljes në afat të pasqyrave financiare të vitit 2020, duke evidentuar personat përgjegjës dhe të marrë masë ndaj tyre në zbatim të shkronjës (e) të nenit 71-Kundërvajtje administrative, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në R.SH”, ndryshuar me ligjin nr. 114/2012/datë 07.12.2012 dhe ligjin nr.57/2016, datë 2.6.2016.

2. Në pasqyrat financiare të përshkruhet qartë baza mbi të cilën janë përgatitur, duke referuar aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për klasifikimin dhe raportimin e pasqyrave financiare. Përgjegjësia për raportim në çdo kohë të jetë e dokumentuar jo nëpërmjet shkresës përcjellëse të dërgimit të pasqyrave, por evidentohet në përgjegjësi të plotë në kapakun e pasqyrave financiare, se kush janë hartuesit dhe drejtuesit.

• Rakordimi i pasqyrave financiare me thesarin dhe bankat e nivelit të dytë si dhe me treguesit e realizimit të buxhetit.

Për vitin 2020 nga verifikimi për çdo muaj i ditarit kontabël të bankës sipas natyrës për shpenzimet e klasës 6 dhe klasës 2 me akt rakordimin e thesarit mbi bazë ekstrate banke (dokumenti i nxjerrjes së llogarisë nga thesari për çdo muaj) për shumat për çdo llogari dhe në total mujor e vjetor rezultoi se ka diferenca. Për këtë janë përdorur ditari i bankës i mbajtur sipas natyrës për autorizimet buxhetore (çeljet) dhe përdorimi fondeve sipas llojit të shpenzimeve në kartelat e llogarive të librit të madh.

➤ Mënyra e mbajtjes së kontabilitetit dhe dokumentacionit bazë e justifikues si dhe sigurimi i informacionit kontabël, përgatitjen e llogarive për vlerësimin e gjendjes pasurore, financiare dhe rezultatit.

Për tu siguruar nëse, regjistrimet kontabël janë kryer në përputhshmëri ligjore dhe me saktësi u kryen teste në regjistrimet në ditarët kontabël në lidhje me:

- mbështetjen në dokumente justifikuese, të verifikuara përsa i përket vlefshmërisë për t'u pranuar në kontabilitet (vlerësimi kontabël);
- mos ndryshueshmëria e regjistrimeve tashmë të kryera dhe e mbartësve të tyre;
- tërësinë e regjistrimeve në mënyrë kronologjike dhe sistematike deri në mbyllje të ushtrimit vjetor.

Nëse informacioni kontabël mundëson, në të gjithë ciklin e tij, kontrollin rrjedhës dhe të mëvonshëm nëpërmjet:

- shqyrtimit të vlefshmërisë së një regjistrimi fillestar duke e krahasuar me dokumentin bazë justifikues;
- kontrollit të vlefshmërisë të një regjistrimi të kryer me anë të një dokumenti duke e krahasuar këtë dokument me dokumentet bazë justifikuese mbi të cilat është përgatitur;
- verifikimit të pajtueshmërisë së shumave të nxjerra nga regjistrimet kronologjike me regjistrimet në llogari (barazimi i lëvizjeve të ditarëve me ato të librit të llogarive) dhe verifikimit të pajtueshmërive të tjera aritmetike.

➤ ***Pohimet e testeve të kryera rreth mbajtjes së kontabilitetit të Aparatit Bashkisë***

Si rezultat i testeve të kryera pohojmë se:

- Kontabiliteti nuk është mbajtur i plotë për të gjitha veprimet kontabël të rezultuara nga kryerja e veprimeve ekonomike, mbi bazën e dokumentacionit bazë dhe justifikues.
- Në këtë bashki, kontabiliteti është organizuar dhe mbahet në mënyrë informatike në program “Excel”.
- Janë zbatuar drejt parimet e përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit, sipas përcaktimeve të dispozitave ligjore për kontabilitetin.

- Azhurnimet e veprimeve ekonomike nuk janë në mënyrë kronologjike dhe kontabilizimet e tyre janë kryer në ditarët e bankës, magazinës, të pagave etj. si dhe janë mbajtur partitarë për llogaritë kreditore e debitorë. Përsa i përket sistemimeve janë evidentuar në kartelat kontabël të llogarive përkatëse dhe artikujve kontabël të prerë për veprime të ndryshme janë evidentuar në librin e veprimeve të ndryshme. Këto libra kontabël janë bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike dhe sistematike të efekteve të veprimeve të kryera, të marra nga dokumentet vërtetuese.
- Në tërësi organizimi i mbajtjes së kontabilitetit ka mundur nxjerrjen e gjendjeve të të llogarive sipas klasave, nisur nga dokumentet bazë justifikuese, të cilat janë të dhëna bazë të hyra në kontabilitet.
- Plotësimi i dokumenteve bazë e justifikues është bërë në mënyrë të plotë, pasi përshkruajnë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban te dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin me te dhënat të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Kështu : Dokumentet vërtetues si Urdhër-shpenzimi, fletë hyrje-daljet, mandat arkëtimet e pagesat, janë të hartuara me të gjitha elementet që kërkon formati i miratuar. Këto dokumente shoqërohen nga dokumente autorizues si kërkesat për financim për veprimet ekonomike të kryera nga drejtoritë përkatëse të miratuar sipas shkallës së hierarkisë, detyrave e përgjegjësisë, duke argumentuar shkakun e veprimit të shoqëruar me urdhrat apo vendimet e organeve drejtuese, kontratat, dokumentet kryesore të procedurave të prokurimit, akt-marrëveshjet etj. Bashkëlidhur këtij dokumentacioni janë dokumentet vërtetues të shpenzimit si faturat, listëpagesat, situacionet e shpenzimeve, procesverbalet, shkresat etj.
- Informacioni kontabël është përgatitur mbi bazën e një kontabiliteti të quajtur të angazhimeve (ose në bazë të të drejtave të konstatuara), duke dhënë elementet e nevojshme për të vlerësuar gjendjen pasurore, gjendjen financiare dhe rezultatet e njësisë ekonomike.

➤ **Baza e dhënies së opinionit të Raportimit Financiar. Pohimet mbi saktësinë e paraqitjes së zërave të pasqyrave financiare.**

Për dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare, u analizuan treguesit e pasqyrave financiare të Bashkisë për aktivitetin ekonomik - financiar 01.01.2020 deri më datën 31.12.2020.

Pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim

Përkatësia: Transaksionet dhe ngjarjet që janë të regjistruara kanë ndodhur dhe i përkasin subjektit.

Plotësia: Të gjitha transaksionet dhe ngjarjet që duhet të ishin regjistruar janë regjistruar, përveç rastit të kontratave të investimeve në vlerë të plotë dhe vlerës së faturave të palikujduara për investime në fund të vitit ushtrimor 2020.

Saktësia: Shumat dhe të dhëna të tjera lidhur me transaksionet e regjistruara dhe ngjarjet nuk janë regjistruar në mënyrë të përshtatshme

Periudha: Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në periudhën e saktë kontabël, përveç disa rasteve të shpenzimeve të kryera për investime, të cilat nuk janë regjistruar në momentin e çeljes së fondeve dhe mbërritjes së faturës.

Klasifikimi: Transaksionet dhe ngjarjet nuk janë regjistruar në llogaritë e duhura.

Ligjshmëria dhe rregullsia: Janë në përputhje me ndarjet buxhetore në dispozicion

Pohimet rreth gjendjeve të llogarive në fund të periudhës

Ekzistenca: Asetet, detyrimet dhe fondet e veta ekzistojnë

Të drejtat dhe detyrimet: Subjekti mban ose kontrollon të drejtat për asetet, detyrimet dhe janë obligimet e subjektit.

Plotësia: Të gjitha asetet dhe fondet e veta janë regjistruar, ndërsa detyrimet nuk janë regjistruar të gjitha në mbyllje të vitit ushtrimor, pra nuk janë të paraqitura të plota në bilanc.

Vlerësimi dhe alokimi: Aktivët, pasivët dhe fondet e veta janë të përfshira në pasqyrat financiare me shumat përkatëse dhe ndonjë vlerësim ose alokim, si dhe rregullimet që rezultojnë janë të regjistruara.

Pohimet rreth prezantimit të shënimeve shpjeguese

Transaksionet, të drejtat dhe detyrimet: Ngjarjet e shpalosura, transaksionet, si dhe çështje të tjera që kanë ndodhur i përkasin subjektit.

Plotësia: Të gjitha informacionet shpjeguese që duhet të ishin përfshirë në pasqyrat financiare nuk janë përfshirë.

Klasifikimi dhe kuptueshmëria: Informacioni financiar është paraqitur në mënyrë të deri diku të përshtatshme dhe të përshkruara, ndërsa mungojnë shënimet që të shprehin paqartësitë e ndodhura.

Saktësia dhe vlerësimi: Informacioni financiar dhe të tjera në përgjithësi është dhënë në mënyrë të drejtë, por jo në sasinë e duhur.

Pasqyrat financiare janë përgatitur nga Drejtoria Ekonomike. **Gjatë fazës së ekzekutimit në terren, u kryen teste të detajeve dhe teste thelbësore, nga ku u konstatua se, nuk janë mbartur saktë tepricat e llogarive dhe se tepricat në çelje për vitin 2020 nuk rakordon me tepricat në mbyllje të vitit 2019.**

Nga verifikimi i gjendjes së llogarive të bilancit të vitit ushtrimor 2020 rezulton se, llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit kundrojnë me formatet anekse pjese e PF, si dhe llogaritë sintetike kundrojnë me ato analitike;

Totali i Aktivit për vitin 2020 është 3,042,622,003 lekë dhe për vitin 2019 është 3,089,689,615 lekë, i paraqitur në formatin 1 dhe i zbërthyer në llogari. (sipas formatit nr.1 të Raport Auditimit)

A. AKTIVE AFATSHKURTRA.

Rakordimi i llogarive me Degën e Thesarit llogaria 520, 466 dhe llogaritë e të Ardhurave.

2. Titulli i gjetjes: Drejtoria e Financës, nuk ka kryer asnjë veprim sipas kushteve të kontratës për c'bllokimin e këtyre fondeve dhe përdorimin e tyre në buxhetin e vet.

Situata:

Llogaritë kryesore të rakordueshme me degën e Thesarit; **llogaria 520** “Disponibilitete në Thesar”, në pasqyrat financiare është për vlerën për vlerën debitorë 32,832,865 **lekë**.

Referuar aktit të rakordimet me Degën e Thesarit Peqin, kjo llogari **është për vlerën 32,823,070 lekë**.

Kjo vlerë sipas aktit të rakordimet me Degën e Thesarit, është e analizuar si vijon:

Të trashëguara nga viti 2019	Lekë
Sipas aktit të rakordimet për shumën. Nga të cilat:	
Grandi I trashëguar	11 007 336
Të ardhura të trashëguara	10 074 296
Mjete në ruajtje të trashëguara (llog. 466)	13 685 415
Fonde specifike	
FZHR	
Tot.	34 767 047
Etj	
Të hyrat (Shtesat debitorë) gjatë vitit.	Lekë

Grandi I vitit	208 840 271
Të ardhurat e vitit	62 049 732
Të hyra nga mjetet në ruajtje	6 878 583
Grandi specifik	
FZHR	
Tot.	277 768 586
Totali I të ardhurave (I+II)	312 535 633
Lëvizjet kreditore të llogarisë	Lekë
Mjete në ruajtje	
Paga sigurime.	169 356 328
Investime	16 934 598
Shpenzime + transferta	87 032 502
Të dala nga mjetet në ruajtje	6 389 135
Tot.	279 712 563
Gjendja debitorë (Saldi) (I+II) – III =	32 823 070

Në këtë rast, llogaria 520 “Disponibilitete në Thesar” e pa rakorduar me të dhënat e Degës së Thesarit, në pasqyrat financiare, nuk pasqyron saktë vlerën e saj në fund të vitit ushtrimor, pasqyruar më shumë në pasqyrat financiare për diferencën 32,832,865- 32,823,070 = **9,795 lekë**,

-Po kështu llogaria 466 “Kreditorë për mjetet në ruajtje” në pasqyrat financiare është për vlerën kontabël **14,188,355 lekë**. Sipas analizës së kësaj llogarie të rakorduar me degën e thesari, kjo llogari është për **vlerën 14,174,863 lekë** dhe është e analizuar sipas objekteve për 21 raste. Në këtë rast, vlera kontabël e kësaj llogarie, nuk është pasqyruar saktë, pasqyruar më shumë për diferencën **(14,188,355- 14,174,863) = 13,492 lekë**.

Nga analiza e përmbajtjes së kësaj llogarie, konstatohet së për 15 subjekte në shumën 6,806,832 lekë gjenden në ngurtësuar fonde nga vitin 2019 për të cilat është përmbushur afati i garancisë dhe nuk është bërë çbllokimi i tyre.

Drejtoria e Financës, nuk ka kryer asnjë veprim sipas kushteve të kontratës për c’bllokimin e këtyre fondeve dhe përdorimin e tyre në buxhetin e vet. (Më hollësisht të dhënat sipas Aneksi Nr. 2 bashkëlidhur)

Kriteri:

Përsa më sipër, janë **shkelje të kërkesave** të UMF nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, Kap. III, pikat 29, 30, 39, 50 dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2011 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kap. II, pika 10.

Ndikimi/Efekti:

Mos funksionimi i këtyre llogarive sipas parimeve kontabël të pranuar, përbën risk lidhur me saktësinë e aktiveve të bilancit me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me të drejtat e lindura të konstatuara, duke paraqitur risk në besueshmërinë dhe përdorimin e tyre nga subjektet e interesuara.

Shkaku:

Drejtoria e Financës, nuk ka kryer asnjë veprim sipas kushteve të kontratës për c’bllokimin e këtyre fondeve dhe përdorimin e tyre në buxhetin e vet.

Rëndësia: E Mesme

Rekomandimi:

Drejtoria e Financës, të marrë masat për sistemimin e llogarive të sipër cituara, bazuar në dokumentacionin ligjor e kontabël;

-Të bëjë sistemimin e llogarive kontabël përse janë konstatuar diferenca më pak ose më shumë sesa aktet e rakordimet me Degën e Thesarit për gjendjen kontabël në fund të vitit ushtrimor 2020.

- **Gjendja e llogarisë 31 “Materiale”** në mbyllje të vitit ushtrimor 2020 paraqitet në vlerën 1,454,328 lekë pakësuar gjatë vitit ushtrimor për vlerën (2,141,995-1,454,323)= 687,632 lekë.

- **Gjendja e llogarisë 32 “Inventari i imët ”** në mbyllje të vitit ushtrimor 2020 paraqitet në vlerën 15,408,487 lekë, shtuar gjatë vitit ushtrimor për vlerën (15,408,487 – 14,796,567)= 611,920 lekë.

- **Gjendja e llogarisë 34 “Produkte ”** në mbyllje të vitit ushtrimor 2020 paraqitet në vlerën 166,434 lekë, pakësuar gjatë vitit ushtrimor për vlerën (285,192 – 166,434)= 118,758 lekë.

Analiza e llogarive debitorë viti. 2020

3. Titulli i Gjetjes: KLSH ka konstatuar se në gjendjen e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” nuk janë përfshirë gjendja e debitorëve për taksa dhe tarifa vendore në vlerën **3,500,000 lekë** e akumuluar në fund të vitit ushtrimor 2020, pasi kjo vlerë nuk është kontabilizuar. Këto detyrime duhet të jenë pjesë e detyrimeve të subjekteve ndaj shtetit. Nuk është kryer kontabilizimi i të ardhurave dhe përfshirja në formatin e performancës financiare të PF i të ardhurave të krijuara është bërë nga evidencat e mbajtura (databaze) nga Drejtoria e taksave dhe tarifave Vendore, ku janë evidentuar të ardhurat sipas llojit në përputhje me klasifikimin e klasës 7 të llogarive.

Situata:

Gjendja e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”, në fillim të vitit 2020 është në vlerën historike **16,483,985 lekë** dhe në fund të vitit 2019 në vlerën historike **16,483,985 lekë**. Gjendja e kësaj llogari është e pa ndryshuar, pasi Drejtoria e Financës nuk ka rakorduar me Drejtorin e taksave mbi gjendjen e debitorëve në mbyllje të pasqyrave financiare për vitin 2020.

Nga analiza e kësaj llogarie konstatohet se në debi të saj janë kontabilizuar debitorët për tatim taksat lokale të subjekteve për shumën 15,453,375 lekë kurse diferenca për shumën 1,030,610 lekë është vlera debitorë e subjektit sipërmarrës të punimeve “Leon Konstruksion” shpk sipas rekomandimeve të KLSH-së nga auditimi i kaluar.

Nga Drejtoria e Financës dhe Drejtoria Juridike e Bashkisë Peqin, **nuk është procedura sipas ligjit përfshi kërkesë padi në Gjykatë** për arkëtimin e detyrimeve debitorë, në kundërshtim me kërkesat ligjore.

Sipas rakordimet me Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit dhe me njoftimet e protokolluara në bashkinë Peqin së bashku me procesverbalet e konstatimit të kundërvajtjes “Ndërtim pa leje”, janë marrë vendime nga kryeinspektori i IMTV për dënime me gjobë në shumat dhe vitet përkatëse si më poshtë;

Nr.	Emër Subjekti	Nr Serisë	Vendim gjobe (nr/datë)	Vlera gjobës	Mandat arkëtim (nr/datë)	Vlera arkëtim it
1	S. C.	0000004	16.09.2019	500,000	<i>Pa paguar</i>	-
2	A. H.	0000002	16.04.2019	500,000	<i>Pa paguar</i>	
3	R. M.	0000008	24.02.2019	500,000	<i>Pa paguar</i>	
4	S. SH.	0000003	16.05.2019	500,000	<i>Pa paguar</i>	
5	B. P	0000006	07.12.2019	500,000	<i>Pa paguar</i>	

Nr.	Emër Subjekti	Nr Serisë	Vendim gjobe (nr/datë)	Vlera gjobës	Mandat arkëtim (nr/datë)	Vlera arkëtim it
6	L. H	0000005	08.10.2019	500,000	<i>Pa paguar</i>	
7	A. H	0000007	09.02.2020	500,000	<i>Pa paguar</i>	
	SHUMA.....			3,500,000	<i>Pa paguar</i>	
	Vlera mbetur.....			3,500,000		

Këto shuma nuk rezultojnë të regjistruara në kontabilitet në llogarinë që debitohet në bilancin kontabël 468 “Debitorë të ndryshëm” dhe llogarinë që kreditohet në pasqyrën e performancës financiare “7115 “Gjoha kamatëvonesa, sekuestrime dhe zhdëmtime”. Pra kemi një nënvlerësim të llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” dhe llogarisë “7115 “Gjoha kamatëvonesa, sekuestrime dhe zhdëmtime” me **3,500,000 lekë** për vitin 2020.

Kriteri:

Këto veprime janë bërë në kundërshtim me ligjin 9228 datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” neni 5, 6, 7, 9 dhe 10, ligjin 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, urdhrit nr.64 datë 22.07.2014 “Për shpallje të Standarteve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuar” dhe Standartit Kombëtar të Kontabilitetit nr.8 “Të ardhurat”, pika 8 e Standartit ku përcaktohet njohja fillestare e të ardhurës.

Ndikimi/Efekti:

Mos funksionimi i këtyre llogarive sipas parimeve kontabël të pranuar, përbën risk lidhur me saktësinë e aktiveve të bilancit me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me të drejtat e lindura të konstatuara, duke paraqitur risk në besueshmërinë dhe përdorimin e tyre nga subjektet e interesuara.

Shkaku

- Nga Drejtoria Ekonomike nuk është kryer kontabilizimi i të ardhurave dhe përfshirja në formatin e performancës financiare të PF i të ardhurave të krijuara është bërë nga evidencat e mbajtura (databaze) nga Drejtoria e taksave dhe tarifave Vendore, ku janë evidentuar të ardhurat sipas llojit në përputhje me klasifikimin e klasës 7 të llogarive.

Rëndësia:-I lartë.

Rekomandimi

Drejtoria Ekonomike në Bashkinë Peqin të mbajë evidencën kontabël për të ardhurat dhe të kryejë veprimet kontabël për evidentimin e debitorëve për taksat dhe tarifën në llog. 468 “debitorë të ndryshëm”, në mënyrë që përfshirja e të ardhurave në pasqyrat financiare të mos bëhet nga jashtë por të ndjekë logjikën kontabël, duke i pozicionuar saktë në llogaritë përkatëse me qëllim që PF të ofrojnë një informacion të saktë mbi të drejta dhe detyrimet e të tretëve ndaj shtetit për taksa dhe tarifa vendore.

- Drejtoria e Financës, në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, të marrë masat e nevojshme për arkëtimin e vlerave debitorë të krijuar në vite duke procedurë me kërkesë padi në Gjykatë, në zbatim të kërkesave ligjore si dhe kontabilizimin e gjobave të vendosura nga IMTV-ja në fund të vitit 2020 në vlerën **3,500,000 lekë**.

II. AKTIVET AFATGJATA

Në formatin nr. 1 “Aktivet Afatgjata” në vlerën neto paraqiten në mbyllje të vitit 2020 në vlerën **2,943,161,366 lekë**.

Klasa 20 “ Aktive Afatgjata jo materiale” që përbëhet nga:

- Gjendja e llogarisë 202 “Studime dhe Kërkime” paraqitet në mbyllje të vitit 2020 në vlerën **15,524,250 lekë**.

Konkluzion:

Vlera e mbetur në fund të vitit 2020 prej **15,524,250 lekë** e aktiveve afatgjata jo materiale e paraqitur në gjendjen e llogarisë 202 “*Studime dhe Kërkime*”, për 18 projekt-studime për investime të kryera nuk është shpërndarë sipas llojit të aktiveve materiale, ku janë kryer investimet, pavarësisht se punimet kanë përfunduar në vitet e mëparshme. Për këtë vlerë ekziston inventar kontabël dhe fizik dhe ruajtja e tyre është bërë në arkiv në çdo dosje teknike të tenderave sipas investimit të kryer në aktivet materiale afatgjatë. Për këto vlera duhet të kryhen veprimet kontabël për kalimin e vlerës së tyre si vlerë e shtuar çdo aktivi afatgjatë material mbi të cilën është kryer investimi mbi bazën e këtyre projekt-studimeve. Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik” **Pika 2. Klasa 2, “Aktivet afatgjata”** (përbërja dhe trajtimi kontabël) e cila përcakton: “*Trajtimet kontabël për AAGJM-në, lidhen me njohjen fillestare të aktivit, si dhe vlerësimin e mëpasshëm:*

a) Njohja fillestare - AAGJM-ja, duhet të plotësojnë kriteret e njohjes në pasqyrën e pozicioni financiar, pra, duhet të vlerësohen me kosto që janë:

- Kostoja e blerjes së bashku me taksat e importit;

- Kosto të tjera të drejtpërdrejta deri në sjelljen e aktivit në vendndodhje apo dhe kosto të tjera që i shtohen nga prodhimi i elementeve të aktivit (**kosto projektimi**, paga dhe kontribute për prodhimin e elementeve të aktivit, materiale të përdorura për këto elemente, kosto transporti, kosto instalimi, kosto testimi etj.).

Aktivet afatgjata jo materiale përcaktohen dhe klasifikohen të tilla si: programet kompjuterike, markat, patentat, licencat, të drejtat e përdoruesit etj. Mund të ketë aktive me karakteristika si të AAGJM-së ashtu edhe të AAGJ/JM-së. Në këto raste, ato klasifikohen në varësi të karakteristikave dominuese. Shembull, një program kompjuterik (soft) përfshihet në AAGJM, nëse është pjesë përbërëse e pajisjeve kompjuterike, në të kundërt (pra, kur nuk është pjesë), trajtohet si AAGJ/JM”

Kreu II. “Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” **Pika 16/b.**

4. Titulli gjetjes: **KLSH konstatoi se, për vitin ushtrimore 2020 llogaria 202 “Studime dhe Kërkime” paraqitet me të njëjtën gjendje në vlerën 15,524,250 lekë, kjo vlerë e cila i përket 18 projekt-studimeve nuk është shpërndarë sipas llojit të aktiveve materiale, ku janë kryer investimet, pavarësisht se punimet kanë përfunduar në vitet e mëparshme.**

Situata:

- **Gjendja e llogarisë 202 “Studime dhe Kërkime”** paraqitet në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 15,524,250 lekë.

Vlera e mbetur në fund të vitit 2020 prej 15,524,250 lekë e aktiveve afatgjata jo materiale e paraqitur në gjendjen e llogarisë 202 “*Studime dhe Kërkime*”, për 18 projekt-studime për investime të kryera nuk është shpërndarë sipas llojit të aktiveve materiale, ku janë kryer investimet, pavarësisht se punimet kanë përfunduar në vitet e mëparshme. Në fakt këto shpenzime për projektimin e një investimi të kryer për krijimin apo rikonstruksionet e aktiveve afatgjata materiale ose AQT nuk duhet të kontabilizohet në llogarinë 202 “*Studime dhe kërkime*” pasi këto janë pjesë e koston së AQT dhe nuk janë shpenzimet për kërkime të aplikuara dhe të zhvillimit. Për këtë vlerë ekziston inventar kontabël dhe fizik dhe ruajtja e tyre është bërë në arkiv në çdo dosje teknike të tenderave sipas investimit të kryer në aktivet materiale afatgjatë.

Kriteri

Përsa trajtuar më sipër, këto veprime janë në kundërshtim me **Udhëzim e MFE nr. 8**, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” **Aneksi 1** “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik” **Pika 2. Klasa 2**, “Aktivet afatgjata” (përbërja dhe trajtimi kontabël), me **VKM nr 783**, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standarteve dhe rregullave kontabël”, Seksioni II “Aktivet e Qëndrueshme Patrupëzuar” **Pika 1/b** “Klasifikimi kontabël” e cila ndër të tjera përcakton se: “Shpenzimet e kërkimeve të aplikuara dhe të zhvillimit - **Llogaria 202**”

Ndikimi/Efekti:

- Mos pasqyrim i saktë i vlerës së plotë të aktiveve afatgjata materiale dhe pozicionimit të pasaktë në llogari të shpenzimeve të studim-projektimit me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të Aktiveve Afatgjata Materiale, duke paraqitur risk në besueshmërinë dhe përdorimin e tyre nga subjektet e interesuara.

Shkaku

- Nga Drejtoria Ekonomike nuk janë marrë masat e nevojshme për saktësimin në kontabilitet të operacioneve të funksionimit në lidhje me procesin e kapitalizmit të aktiveve.

Rëndësia:-I Mesëm

Rekomandimi:

Drejtoria Ekonomike në Bashkinë Peqin të kryejë veprimet e sistemimit në kontabilitet për shpërndarjen e vlerës së studim-projektiveve sipas investimeve të kryera dhe për çdo lloj aktivi afatgjatë material si pjesë e kostos së tij, duke kredituar llog. 202 “Studime dhe Kërkime” dhe debituar llogaritë përkatëse të klasës 21 për vlerat e mbetura koresponduese, në mënyrë që aktivet sipas llojit të paraqiten në vlerë të plotë.

II. AKTIVE AFATGJATA MATERIALE

Auditimi i aktiveve afatgjata materiale:

1. Objektivat e auditimit të aktiveve afatgjata materiale, janë që të sigurohemi se:

Aktivet ekzistojnë; ato i përkasin subjektit; janë të vlerësuara në mënyrë korrekte; janë regjistruar në mënyrë korrekte; është bërë mirë ndarja midis shpenzimeve dhe aktiveve të qëndrueshme; informacionet që ndodhen në aneksin përkatës janë të plota dhe korrekte.

2. Kontrolle të përgjithshme të llogarive dhe dokumenteve:

- Për auditimin e aktiveve **afatgjata materiale**, u kryen një numër kontrollesh të përgjithshme si:

- U verifikua tabela e lëvizjeve të aktiveve **afatgjata materiale** në raport me gjendjet dhe ndryshimin e tyre gjatë periudhës ushtrimore;

- U ekzaminua tabela e lëvizjeve, nëse ka ndodhur ndonjë variacion anormal mbi aktivet **afatgjata materiale**;

- U ekzaminuan të gjitha shpjegimet që janë paraqitur lidhur me shmangiet dhe përjashtimet e veçanta;

- U verifikua nëse parimet kontabël të ndjekura prej subjektit për vlerësimin dhe kontabilizimin janë konformë parimeve të përgjithshme të pranuar dhe udhëzimeve përkatëse.

- U verifikua nëse shifrat e çeljes rakordojnë me ato të mbylljes së ushtrimit të mëparshëm;

- U krahasuan investimet e realizuara gjatë ushtrimit me ato të planifikuara në buxhet.

3. Disa nga parimet e zbatuara për auditimin e aktiveve afatgjata materiale:

a. Gjatë hyrjes së aktiveve në pronësinë e subjektit, duhet të sigurohemi se veprimet janë kryer në zbatim të kërkesave të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

- Për Aktivet e blera janë kryer teste për 4 kampione në dokumentet bazë të hyrjes dhe kartelat analitike kontabël nëse janë kontabilizuar sipas vlerës së tyre të marrjes. (çmimit të blerjes shtuar shpenzimet e tjera të nevojshme për vënien në gjendje përdorimi të pasurisë);
- Për Aktivet e marra falas janë kryer teste për 3 kampione në dokumentet bazë të hyrjes dhe kartelat analitike kontabël nëse janë kontabilizuar duke i vlerësuar ato me vlerën e shitjes;
- Aktivet e sjella në subjekt (kalim kapital) janë kryer teste për 2 kampione në dokumentet bazë të hyrjes dhe kartelat analitike kontabël nga të tretët nëse kontabilizohet me vlerën e tyre të sjelljes.

b. Për inventarin, janë kryer teste për tu siguruar që subjekti:

- Proçedon për regjistrimin dhe vlerësimin e aktiveve të saj të qëndrueshme sipas rregullave kontabël përgjithësisht të pranuar;
- Përdor referencat ose teknikat më të përshtatshme për natyrën e pasurisë (çmimi i tregut, tabelat e publikuara, treguesit specifike, etj.);
- Ka ruajtur të njëjtat rregulla vlerësimi nga një inventar në tjetrin.

Në formatin nr. 1 (Aktiv i bilancit) “Aktivet afatgjata materiale” në mbyllje të vitit 2020 paraqiten në shumën totale prej 2,728,592,643 lekë. Për këto aktive janë kryer inventarë fizike nga komisioni inventarizimit, i ngritur nga Bashkia Peqin të paraqitura nëpërmjet fletëve të inventarizimit të hartuara dhe të konfirmuara nga ky komision. Kjo llogari sintetike e analizuar paraqitet në llogaritë e mëposhtme:

- **Gjendja e llog. 210 “Toka, Troje, Terrene”** është në vlerën 5,612,083 lekë e pandryshuar si në mbyllje të vitit 2019, për të cilën ka inventar kontabël, por jo inventar fizik. Këto gjendje paraqiten të analizuar sipas vlerës bruto në tabelën e mëposhtme:

Inventari kontabël i llogarisë 210 "Toka Troje Terrene" me date 31.12.2020

Nr.	EMERTIMI	GJENDJA 31.12.2020
	Toka ndert. Pallatit tek Portokallet	956,000
	Shpronësim rruga e Tatimeve	2,461,469
	Lulishte nga ana e sahatit	994,614
	Shpronësim toka e varrezave	1,200,000
	Shuma teprica datë 31.12.2020	5,612.083

- **Gjendja e llogarisë 211 “Pyje, Plantacione” për vitin 2020** paraqitet në vlerën kontabël 11,703,428 lekë. Kjo vlerë përfshin kostot e mbjelljes së pemëve dekorative dhe frutore në territorin e Bashkisë Peqin për të cilat ekzistonte inventari fizik në numër drurësh. Analiza dhe inventari fizik në vlerën bruto paraqiten në tabelën e mëposhtme:

NR	Emërtimi	Gjendje me 31.12.2020	Sasia	Çmimi	Shtesa 2020	Gjendja me 31.12.2020
	PYJE,KULLOTA,PLANTACIONE	13,928,877				13,928,877

- **Gjendja e Llogarisë 212 “Ndërtesa Konstruksione”** në mbyllje të vitit 2020 paraqitet në vlerën 502,621,806 lekë dhe në mbyllje të vitit 2019 paraqitet në vlerën 509,576,217 lekë për të cilat ka inventar fizik. Gjatë vitit kjo llogari është shtuar për vlerën 18,524,399 lekë. Diferenca në ulje në vlerën 25,478,810 lekë vjen si pasojë e llogaritjes së amortizimit, sipas pasqyrës aneks 2.1.1, bashkëlidhur.

- **Gjendja e Llogarisë 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”** në mbyllje të vitit 2020 paraqitet në vlerën 2,181,425,960 lekë dhe në mbyllje të vitit 2019 paraqitet në vlerën 2,233,955,109 lekë

për të cilat ka inventar fizik lekë. Diferenca në ulje prej 52,569,149 lekë e gjendjes kontabël të vitit ushtrimor 2020 nga viti 2019 përfaqëson investime e kryera në vlerën bruto 59,133,606 lekë–amortizimi në vlerën 111,699,755 lekë. Analiza e gjendjes kontabël së kësaj llogaritje edhe sipas inventarit fizik si dhe ndryshimet nga viti 2020 paraqiten në pasqyrën aneks 2.1.2, bashkëlidhur Raport Auditimit.

- **Gjendja e llogarisë 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune”** në mbyllje të vitit 2020 paraqitet në vlerën 1,536,508 lekë dhe në mbyllje të vitit 2019 paraqitet në vlerën 2,151,308 lekë për të cilat ka inventar fizik lekë. Diferenca në ulje prej 614,800 lekë e gjendjes kontabël të vitit ushtrimor 2020 nga viti 2019 përfaqëson blerje në vlerën bruto 425,200 lekë–amortizimi në vlerën 1,040,000 lekë. Analiza e gjendjes kontabël së kësaj llogaritje është sipas kostos historike edhe sipas inventarit fizik si dhe ndryshimet nga viti 2020 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

-Llogaria 214 “Instalime teknike, makineri pajisje, vegla pune”

Nr.	EMERTIMI	GJENDJA 31.12.2020
1	Aparati I Bashkisë	5,059,069
2	Zjarrfikësja	271,388
3	Kultura	756,571
4	Mirembajtje e rrugëve	280,571
5	Pyjore	55,050
6	Sporti	399,700
7	Shkolla e mesme Peqin	3,687,946
8	shkolla 9-vjecare D. Godelli	1,214,051
9	Shkolla 9-vjecare A.Bedalli	1,098,170
10	Njësia Admin. Perparim	535,032
11	Njësia Admin. Pajove	1,932,632
12	Njësia Admin. Sheze	1,588,903
13	Njësia Admin. Gjocaj	3,693,288
14	Njësia Admin. Karine	4,024,461
	Shuma teprica datë 31.12.2020	24,596,832

- **Gjendja e llogarisë 215 “Mjete Transporti”** në mbyllje të vitit 2020 paraqitet në vlerën 6,066,109 lekë dhe në mbyllje të vitit 2019 paraqitet në vlerën 9,337,665 lekë. Diferenca në ulje prej 3,271,556 lekë e gjendjes kontabël të vitit ushtrimor 2020 nga viti 2019 përfaqëson blerje e Automjeti në vlerën bruto 2,308,800 lekë–amortizimi në vlerën 5,580,356 lekë.

Vlera historike e 9 automjeteve në inventar të bashkisë, është 30,210,580 lekë e cila është paraqitur në Formatin 7/b “Gjendja dhe ndryshimet aktiveve afatgjata (kosto historike)” të PF. Analiza e gjendjes kontabël së kësaj llogaritje edhe sipas inventarit fizik si dhe ndryshimet nga viti 2020 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Inventari kontabël i llogarisë 215 "mjete transporti " me 31.12.2020

Nr.	EMERTIMI	GJENDJA 31.12.2020
1	Benx"Avangart „	2040000
2	Autoveturë Tayota AA...0DR	4311784
3	Mercedesbenz E 220	2484000
4	Makine Benz	1510800
5	Kamion me vinç	2400000
6	Fadrom cot 4280	3600000
7	Eskavat.me zinxh."Volvo	9055196
8	Fadrom cot 4280	2308800
9	Zjarrfikësja	2500000
	Shuma teprica datë 31.12.2020	30,210,580

- **Gjendja e llogarisë 218** “Inventar Ekonomik” në datën 31.12.2020 është në vlerën kontabël 19,626,749 lekë, ndërsa në datën 31.12.2019 është në vlerën 28,050,909 lekë. Në këto gjendje përfshihen: shtesa prej 2,728,560 lekë–amortizimi në vlerën 11,387,933 lekë. **Gjendja e aktiveve afatgjata** në vlerën bruto dhe neto si dhe ndryshimet nga viti 2020 në vitin 2019 paraqiten në Formatin nr.7/B “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” të PF si më poshtë:

Llog	EMERTIMI	Teprica ne fillim			Shtesat gjate vitit		Teprica ne Fund		
		Kosto Historike	Amortizim Akumuluar	Teprica Neto	Kosto Historike	Amortizim	Kosto Historike	Amortizim Akumuluar	Teprica Neto
b	c	1	2	3	4	5	8	9	10
20	I. AAGJ/JO MATERIALE	11,077,800	4,544,280	6,533,520	10,652,400	1,661,670	21,730,200	6,205,950	15,524,250
201	Prime te emisionit dhe rimbursimit te huave	0	0	0	0	0	0	0	0
202	Studime dhe kërkime	11,077,800	4,544,280	6,533,520	10,652,400	1,661,670	21,730,200	6,205,950	15,524,250
203	Koncesione, patenta,licenca e tjera ngjashme	0	0	0	0	0	0	0	0
21-28	II. AAGJ/ MATERIALE	3,311,629,052	510,351,151	2,801,042,688	83,117,565	155,802,823	3,394,746,617	666,153,974	2,728,592,643
210	Toka,troje,Terene	5,612,083	0	5,612,083	0	0	5,612,083	0	5,612,083
211	Pyje,Kullota Plantacione	13,928,877	1,609,480	12,319,397	0	615,969	13,928,877	2,225,449	11,703,428
212	Ndertime e Konstruksione	637,530,263	127,954,046	509,576,217	18,524,399	25,478,810	656,054,662	153,432,856	502,621,806
213	Rruge,rrjete,vepra ujore	2,545,544,752	311,549,643	2,233,995,109	59,130,606	111,699,755	2,604,675,358	423,249,398	2,181,425,960
214	Instalime teknike,makineri,pajise,vegla pune	24,171,632	22,020,324	2,151,308	425,200	1,040,000	24,596,832	23,060,324	1,536,508
215	Mjete transporti	27,901,780	18,564,115	9,337,665	2,308,800	5,580,356	30,210,580	24,144,471	6,066,109
216	Rezerva shtetore	0	0	0	0	0	0	0	0
217	Kafshe pune e prodhimi	0	0	0	0	0	0	0	0
218	Inventar ekonomik	56,939,665	28,653,543	28,050,909	2,728,560	11,387,933	59,668,225	40,041,476	19,626,749
24	Aktive te Qend.te trupezuara te demtuara	0	0	0	0	0	0	0	0
28	Caktime	0	0	0	0	0	0	0	0
	TOTALI (I + II)	3,322,706,852	514,895,431	2,807,576,208	93,769,965	157,464,493	3,416,476,817	672,359,924	2,744,116,893

Konkluzion:

Gjendja kontabël e aktiveve afatgjata materiale (në vlerën bruto) për vitin 2020 në vlerën 3,416,476,817 lekë dhe për vitin 2019 në vlerën 3,322,706,852 lekë është paraqitur i plotë, pasi janë pasqyruar të gjitha shtesat dhe pakësimet për çdo lloj grup aktiv. Inventari kontabël i aktiveve materiale gjendje në llogaritë: 210 “Toka, Troje, Terrene” është në vlerën 5,612,083 lekë; 211 “Pyje, Plantacione” në vlerën 13,928,877 lekë, 212 “Ndërtesa Konstruksione” në vlerën 656,054,662 lekë; 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” në vlerën 2,604,675,358 lekë; 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” në vlerën 24,596,832 lekë nuk është i qartë në përcaktimet e emërtesave dhe vlerave të secilit aktiv artikull për artikull, duke mos përcaktuar vlerën e plotë të çdo aktiv, e cila duhet të përfshijë vlerën fillestare dhe shtesat gjatë viteve të secilit aktiv. Në këto inventarë janë azhurnuar bruto të gjithë investimet e kryera për të gjithë aktivet brenda llojit sipas emërtesave të projekteve të investimeve pa i ndarë dhe përmbledhur në një vlerë të vetme totale për çdo aktiv.

Nga Dega e Thesarit Peqin nuk është kërkuar regjistri aktiveve për regjistrimin në sistemin informatikë financiar të qeverisë (SIFQ). Pra nuk ka një data basë me të dhënat aktiv për aktiv vetëm për Bashkinë Peqin, pra duke mos u kryer procesi i informatizimit të tyre.

Kjo mënyrë evidentimi dhe proces inventarizimi, nuk jep informacion të saktë kontabël për çdo aktiv, duke mos “certifikuar” vlerat tek për tek të aktiveve, për të ofruar siguri të arsyeshme rreth vlerës fizike dhe kontabël të tyre, të njohura dhe regjistruara në pasqyrat financiare të njësisë.

Nga auditimi i dokumentacionit rezultoi:

Për vitin 2020 nga auditimi i procedurës së mbajtjes dhe kontabilizimit të aktiveve rezultoi se çdo aktiv ishte i regjistruar dhe i kontabilizuar sipas dispozitave ligjore por njësia nuk dispononte një regjistër analitik aktivesh sipas formatit, ku duhet të përmbajë: datën e hyrjes ose marrjen në dorëzim, përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vendodhje, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, datën e daljes nga pronësia, në formë analitike në kundërshtim me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” kapitulli III, pika 30.

5. Titulli gjetjes: *KLSH ka konstatuar se në vitin ushtrimore 2020 gjendja kontabël e aktiveve afatgjata materiale (në vlerën bruto) për vitin 2020 në vlerën 3,416,476,817 lekë dhe për vitin 2019 në vlerën 3,322,706,852 lekë është paraqitur i plotë, pasi janë pasqyruar në mënyrë të sintetizuar të gjitha shtesat dhe pakësimet, Nga verifikimi i inventarëve kontabël rezultoi se janë azhurnuar bruto të gjithë investimet e kryera për të gjithë aktivet brenda llojit sipas emërtesave të projekteve të investimeve pa i ndarë dhe përmbledhur në një vlerë të vetme totale për çdo aktiv. Për këto aktive mungojnë kartelat kontabël apo regjistri historik për çdo aktiv me të dhënat për veprimet ekonomike të kryera me to në vite si: viti i hyrjes, përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes, vlerën e shpenzimeve kapitale të kryera në vitet e mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vlerën e akumuluar të amortizimit dhe vlerën e mbetur.*

Situata:

Gjendja kontabël e aktiveve afatgjata materiale (në vlerën bruto) për vitin 2020 në vlerën 3,416,476,817 lekë dhe për vitin 2019 në vlerën 3,322,706,852 lekë është paraqitur i plotë, pasi janë pasqyruar të gjitha shtesat dhe pakësimet për çdo lloj grup aktiv. Inventari kontabël i aktiveve materiale gjendje në llogaritë: 210 “Toka, Troje, Terrene” është në vlerën 5,612,083 lekë; 211 “Pyje, Plantacione” në vlerën 13,928,877 lekë, 212 “Ndërtesa Konstrukione” në vlerën 656,054,662 lekë; 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” në vlerën 2,604,675,358 lekë; 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” në vlerën 24,596,832 lekë nuk është i qartë në përcaktimet e emërtesave dhe vlerave të secilit aktiv artikull për artikull, duke mos përcaktuar vlerën e plotë të çdo aktivit, e cila duhet të përfshijë vlerën fillestare dhe shtesat gjatë viteve të secilit aktiv. Në këto inventarë janë azhurnuar bruto të gjithë investimet e kryera për të gjithë aktivet brenda llojit sipas emërtesave të projekteve të investimeve pa i ndarë dhe përmbledhur në një vlerë të vetme totale për çdo aktiv.

Nga Dega e Thesarit Peqin nuk është kërkuar regjistri i aktiveve për regjistrimin në sistemin informatik financiar të qeverisë (SIFQ). Pra nuk ka një data basë me të dhënat aktiv për aktiv vetëm për Bashkinë Peqin, pra duke mos u kryer procesi i informatizimit të tyre.

Kjo mënyrë e evidentimit dhe procesi i inventarizimit, nuk jep informacion të saktë kontabël për çdo aktiv, duke mos “certifikuar” vlerat tek për tek të aktiveve, për të ofruar siguri të arsyeshme rreth vlerës fizike dhe kontabël të tyre, të njohura dhe regjistruara në pasqyrat financiare të njësisë.

Kriteri

Përsa trajtuar më sipër, këto veprime janë në kundërshtim me ne kundërshtim me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” kapitulli III, pika 30.

Ndikimi/Efekti:

Kjo mënyrë e evidentimit dhe procesi i inventarizimit, nuk jep informacion të saktë kontabël për çdo aktiv, duke mos “certifikuar” vlerat tek për tek të aktiveve, për të ofruar siguri të arsyeshme rreth vlerës fizike dhe kontabël të tyre, të njohura dhe regjistruara në pasqyrat financiare të njësisë.

Shkaku

- Nga Drejtoria Ekonomike nuk janë marrë masat e nevojshme që për këto aktive të mbahen kartelat kontabël apo regjistri historik për çdo aktiv me të dhënat për veprimet ekonomike të kryera me to në vite si: viti i hyrjes, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, vlerën e shpenzimeve kapitale të kryera në vitet e mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vlerën e akumuluar të amortizimit dhe vlerën e mbetur.

Rëndësia:-I mesëm.

Rekomandimi

Drejtoria Ekonomike në Bashkinë Peqin të kryejë veprimet për krijimin dhe mbajtjen e një regjistri analitik aktivesh sipas formatit, ku duhet të përmbajë: datën e hyrjes ose marrjen në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendodhje, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, datën e daljes nga pronësia, në formë analitike.

▪ Inventarizimi i aktiveve për vitin 2020 Bashkia Peqin

6. Titulli i Gjetjes: *Nuk janë marrë masat e nevojshme për miradministrimin e të gjitha Aktiveve afatgjatë materiale dhe jo materiale. Konkretisht për llogaritë e Aktiveve me vlerat neto sipas të dhënave të Pasqyrave Financiare të vitit 2020:*

Situata:

Në lidhje me zbatimin e dispozitave ligjore për kryerjen e procedurave të inventarizimit të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara dhe qarkulluese rezultoi se:

Në bazë të UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” është kryer procesi i inventarizimit të aktiveve në fund të vitit 2020 për Bashkinë Peqin dhe Njësit Administrative.

Nga Titullari për kryerjen e procesit të inventarizimit kanë dalë urdhrat nr. 265 datë 12.10.2020 i cili ka përcaktuar komisionin e inventarizimit dhe vlerësimit për pajisjet e inventarit ekonomik (llog.218) dhe pajisjeve teknike (llog.214), mjeteve të transportit (llog.215), në pronësi të aparatit të Bashkisë Peqin i përbërë nga 5 anëtarë me qëllim vërtetimin e saktësisë së gjendjes fizike të objekteve të inventarëve në raport me të dhënat e sistemit kontabël si dhe të sigurojë që aktivet në përdorim janë ngarkuar tek personat përgjegjës konformë procedurave ligjore.

Nga auditimi i dokumentacionit të mbajtur për kryerjen e inventarizimit rezultoi se komisionet e inventarizimit kanë hartuar fletët e inventarëve me gjendjen fizike të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara e të grupëzuara dhe gjendjen kontabël sipas llogarive si për Bashkinë Peqin dhe për Njësit Administrative . Në kolonën shënime nga komisioni nuk ka vlerësime të aktiveve të veçanta për gjendje jashtë përdorimi. Fletët e inventarëve janë të konfirmuara nga komisioni dhe përgjegjës material.

Në fund të procesit të inventarizimit janë hartuar relacionet e rezultatit të procesit të inventarizimit, për vitin 2020 Në këto relacione janë listuar aktivet sipas llogarive duke krahasuar gjendjet kontabël me gjendjet fizike, nga ku rezultuar se nuk ka diferenca.

Për vitin 2020 nuk ka nxjerrje jashtë përdorimi të aktiveve.

Por u konstatua se:

Nga Bashkia Peqin, ***nuk janë kryer procedurat për inventarizimin*** e të gjitha aktiveve afat gjata jo materiale dhe materiale të investuara në vite nga Bashkia Peqin dhe ato që me miratim të Këshillit të Ministrave, kanë kaluar në pronësi të kësaj bashkie, konkretisht për llogaritë (me kostot historike):

Llogaria 202 “*Studime dhe kërkime*” për 21,730,200 lekë.

Llogaria 210 “*Toka, troje, terrene*” për 5,612,083 lekë.

Llogaria 211 “*Pyje kullota plantacione*” për 13,928,877 lekë.

Llogaria 212 “*Ndërtime konstruksione*” për 656,054,622 lekë.

Llogaria 213 “*Rrugë rrjete vepra ujore*” për 2,604,675,358 lekë.

Llogaria 214 “*Instalime teknike, makineri pajisje, vegla pune*” për 24,596,832 lekë.

Llogaria 215 “*Mjete transporti*” për 30,210,580 lekë.

-Nuk është përgatitur regjistri i pronave.

-Nuk është bërë regjistrimi i aktiveve në pronësi të Bashkisë.

Kriteri:

Përsa më sipër, mosveprimet janë **në kundërshtim** me kërkesat e ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, Kap. III, neni 9, pika 1.2 - Të drejtën dhe përgjegjësinë e pronësisë; Kap. VII, neni 23, pika 14 –Planifikimin, administrimin, zhvillimin dhe kontrollin e territorit, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj , UMF nr. 30, datë 27.12.2011“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar pikat 26, 27, 30 dhe 74, dhe UMF nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”. Kap III- Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në Njësitë e Qeverisjes së përgjithshme, pika 30 ku citohet: “Çdo njësi e qeverisjes së përgjithshme kryen verifikimin fizik të aktiveve dhe elementeve të tjera, konformë kriterëve të përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore, si dhe saktëson vërtetësinë e llogarive të të drejtave e të detyrimeve ndaj të tretëve. Mbi këtë bazë, në kontabilitet, bëhen veprimet për sistemimin e diferencave të gjendjes fizike me gjendjen kontabël për llogari të vitit kontabël që mbyllet.”

Ndikimi/Efekti:

Mos pasqyrim i saktë i vlerës së plotë të aktiveve afatgjata materiale dhe pozicionimit të pasaktë të llogarive, me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të Aktiveve Afatgjata Materiale, duke paraqitur risk në besueshmërinë dhe përdorimin e tyre nga subjektet e interesuara.

Shkaku:

Nga Drejtoria Ekonomike nuk janë marrë masat e nevojshme për saktësimin në kontabilitet të operacioneve të funksionimit në lidhje me procesin e kapitalizmit të aktiveve.

Rëndësia:- E Lartë.

Rekomandimi:

Kryetari i Bashkisë, të marrë masat që me specialistë të fushës, të inventarizojë dhe saktësojë pronat sipas të dhënave të kontabilitetit, regjistrimin e pronave në pronësi të vet, të kaluara me VKM-të përkatëse, si dhe për krijimin e regjistrit të pronave, në zbatim të kërkesave të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar dhe ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar.

- Gjendja e llogarisë 219 “Amortizimi i AQ materiale dhe jo materiale” paraqitet në bilanc në vlerën 672,359,924 lekë e cila kuadron me pasqyrën e amortizimit të bilancit në formatin nr. 7/b, kolona 9.

“Amortizimi i AQ të Trupëzuara dhe të Patrupëzuara” është llogaritur sipas normave ligjore të miratuara në përputhje me UMF nr.8, datë 9.3.2018”Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes

dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme” pika 36

Përlllogaritja është bërë mbi vlerën neto në çelje të periudhës ushtrimore për çdo grup aktive sipas klasifikimit. U bënë sondazhe në llogari të ndryshme për aktive të veçanta në tabelat e detajuara të aktiveve dhe llogaritjes së amortizimit sipas normave ligjore të amortizimit të përcaktuara, nga ku rezultoi se përlllogaritjet ishin bërë të sakta. Vlerat e akumuluar të amortizimit sipas llogarive dhe veprimeve në kontabilitet paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Llog	EMERTIMI	Teprica ne fillim			Shtesat gjate vitit		Teprica ne Fund		
		Kosto Historike	Amortizim Akumuluar	Teprica Neto	Kosto Historike	Amortizim	Kosto Historike	Amortizim Akumuluar	Teprica Neto
b	c	1	2	3	4	5	8	9	10
20	I. AAGJ/JO MATERIALE	11,077,800	4,544,280	6,533,520	10,652,400	1,661,670	21,730,200	6,205,950	15,524,250
201	Prime te emisionit dhe rimbursimit te huave	0	0	0	0	0	0	0	0
202	Studime dhe kërkime	11,077,800	4,544,280	6,533,520	10,652,400	1,661,670	21,730,200	6,205,950	15,524,250
203	Koncesione, patentat, licenca e tjera ngjashme	0	0	0	0	0	0	0	0
21-28	II. AAGJ/ MATERIALE	3,311,629,052	510,351,151	2,801,042,688	83,117,565	155,802,823	3,394,746,617	666,153,974	2,728,592,643
210	Toka,troje,Terene	5,612,083	0	5,612,083	0	0	5,612,083	0	5,612,083
211	Pyje, Kullota Plantacione	13,928,877	1,609,480	12,319,397	0	615,969	13,928,877	2,225,449	11,703,428
212	Ndërtime e Konstruksione	637,530,263	127,954,046	509,576,217	18,524,399	25,478,810	656,054,662	153,432,856	502,621,806
213	Rruge,rrjete,vepra ujore	2,545,544,752	311,549,643	2,233,995,109	59,130,606	111,699,755	2,604,675,358	423,249,398	2,181,425,960
214	Instalime teknike,makineri,paisje,vegla pune	24,171,632	22,020,324	2,151,308	425,200	1,040,000	24,596,832	23,060,324	1,536,508
215	Mjete transporti	27,901,780	18,564,115	9,337,665	2,308,800	5,580,356	30,210,580	24,144,471	6,066,109
216	Rezerva shtetore	0	0	0	0	0	0	0	0
217	Kafshe pune e prodhimi	0	0	0	0	0	0	0	0
218	Inventar ekonomik	56,939,665	28,653,543	28,050,909	2,728,560	11,387,933	59,668,225	40,041,476	19,626,749
24	Aktive te Qend.te trupezuara te demtuara	0	0	0	0	0	0	0	0
28	Caktime	0	0	0	0	0	0	0	0
	TOTALI (I + II)	3,322,706,852	514,895,431	2,807,576,208	93,769,965	157,464,493	3,416,476,817	672,359,924	2,744,116,893

Në analizë e detajuar e llogarive të pasqyruara në formatin 7/b të pasqyrave financiare rezultoi se gjendja teprice e llogarive të Aktiveve Afatgjata është në vlerën **2,744,116,893 lekë**. Vlerë e cila nuk rakordon me formatin nr. 1 në Aktiv të Pasqyrave Financiare e cila paraqitet në vlerën 2,943,161,366 lekë . Përsa trajtuar më sipër, këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzim e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik” Pika 2. Klasa 2, “Aktivet afatgjata” (përbërja dhe trajtimi kontabël).

7. Titulli i Gjetjes :*Mbi kontabilizimin e kontratave të investimit dhe njohjes së të drejtës për financimet e pritshme nga buxheti i shtetit për këto investime publike për vitin 2020.*

Situata:

Llogaria 4342 “Të tjera operacione me shtetin (debitor datë 31.12.2020)” në aktiv të pasqyrave financiare (Formati nr.1), paraqitet në vlerën 0 lekë pozicionimi i kësaj llogarie është bërë në mënyrë të gabuar. Pasi kjo llogari përbëhet nga detyrimet afatshkurtra për muajin dhjetor 2019 të cilat trashëgohen në vitin 2020, e cila në analizë përfshin gjendjet e llogarive në pasivin e bilancit: llog.401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” për vlerën 30,134,750 lekë, llog.42 “Detyrime ndaj personelit” për vlerën 26,290,063 lekë, llog.431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa” për vlerën 677,405 lekë, llog.435 “Sigurime

shoqërore” për vlerën 3,246,772 lekë, llog. 436 “Sigurime shëndetësore” për vlerën 443,959 lekë

Kriteri:

Baza ligjore mbi të cilën është vlerësuar situata e cila paraqet parregullsi janë: ligjin 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 6, neni 10 dhe 11, të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, ligjin nr. 25/2018 datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 32.

Ndikimi/Efekti:

Mos regjistrimi në kontabilitet dhe deformim i informacionit financiar, për sa i përket gjendjes kontabël të drejtave që i lindin subjektit Bashkia Peqin ndaj shtetit për angazhimet e ndërmarra me fondet nga buxheti i shtetit, të paraqitur në Pasqyrat e Pozicionit Financiar për vitin 2020 si dhe në Pasqyrën e Performancës Financiare.

Shkaku:

Mos njohja dhe mos zbatim i ligjit 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 6, neni 10 dhe 11; të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” i shfuqizuar, ligjin nr. 25/2018 datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” dhe Udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

Rëndësia:- E Lartë.

Rekomandime:

Nga Bashkia Peqin, nëpërmjet Nëpunësit Zbatues, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet të llogarisë 4342 *Operacione me shtetin*” dhe kundër partisë 7206 *“Financim i pritshëm nga buxheti”* për shumën 60,792,949 lekë për vitin 2020 Veprimet e sistemuese të bëhen me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2021.

Analiza e llogarive kreditore viti. 2020

- **Llogarisë 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”** paraqitet në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 30,134,750 lekë, dhe në mbyllje të vitit 2019 në vlerën 10,511,789 lekë, ku diferenca prej 19,622,961 lekë përfaqëson detyrimeve ndaj të tretëve për fatura të palikujduara gjatë vitit ushtrimor 2020. Sipas analizës së gjendjes së kësaj llogarie rezulton se ajo përbëhet nga 7 fatura të palikujduara të krijuara gjatë vitit 2020 për mallra dhe shërbime në vlerën 1,235,440 lekë dhe nga **18 raste detyrimesh për investime në vlerën 12,898,165 lekë**, Nga analiza e kësaj e këtyre llogarive, sipas dokumentacionit që na u paraqit, **konstatohet se vlera 18,010,183 lekë** duhet të kontabilizoheshin në **llog. 467 “Kreditorë të ndryshëm”** për detyrime të prapambetura ndaj të tretëve. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzim e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik” Pika 3.3/c. d “Trajtimi kontabël dhe funksioni i llogarive të të tretëve (klasa 4)” në të cilat përcaktohen: “c) Konstatohen e paguhen shpenzime korrente e kapitale:

- Debitohet klasa 6 ose 23 (sipas analizave përkatëse);
- Kreditohet 401, 404, 467 e të tjera me analiza, kur detyrimi paguhet më vonë;
- Kreditohet klasa 5 llogaritë financiare (kur paguhet menjëherë).

d) Paguhen detyrime të konstatuara më parë:

- Debitohen llogaritë 401, 404, 467;
- Kreditohet klasa 5 e “Llogarive financiare”.

Me VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël” Kapitulli IV “Llogaritë e të tretëve, klasa 4” Seksioni I “Përbërja, klasifikimi dhe sqarime të përgjithshme” pika 2 në të cilën ndër të tjera përcaktohet: “ Në llogarinë 467 regjistrohen shumat e kërkesave për arkëtim ose të detyrimeve që rrjedhin nga veprime të tjera. Kjo llogari ndahet në llogari të tjera për të mundësuar regjistrimin veças të kërkesave nga detyrimet në respektim të parimit të mos kompensimit.”

8. Titulli i gjetjes: *Llogarisë 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” paraqitet në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 30,134,750 lekë, dhe në mbyllje të vitit 2019 në vlerën 10,511,789 lekë, ku diferenca prej 19,622,961 lekë përfaqëson detyrimeve ndaj të tretëve për fatura të palikujduara gjatë vitit ushtrimor 2020. Sipas analizës së gjendjes së kësaj llogarie rezulton se ajo përbëhet nga 7 fatura të palikujduara të krijuara gjatë vitit 2020 për mallra dhe shërbime në vlerën 1,235,440 lekë dhe nga **18 raste detyrimesh për investime në vlerën 12,898,165 lekë**, Nga analiza e kësaj e këtyre llogarive, sipas dokumentacionit që na u paraqit, konstatohet se **vlera 18,010,183 lekë duhet të kontabilizoheshin në llog. 467 “Kreditorë të ndryshëm”** për detyrime të prapambetura ndaj të tretëve. (Në mënyrë të detajuar paraqitet në aneksin nr. ,1)*

Situata:

Llogarisë 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” paraqitet në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 30,134,750 lekë, dhe në mbyllje të vitit 2019 në vlerën 10,511,789 lekë, ku diferenca prej 19,622,961 lekë përfaqëson detyrimeve ndaj të tretëve për fatura të palikujduara gjatë vitit ushtrimor 2020. Sipas analizës së gjendjes së kësaj llogarie rezulton se ajo përbëhet nga 7 fatura të palikujduara të krijuara gjatë vitit 2020 për mallra dhe shërbime në vlerën 1,235,440 lekë dhe nga **18 raste detyrimesh për investime në vlerën 12,898,165 lekë**, Nga analiza e kësaj e këtyre llogarive, sipas dokumentacionit që na u paraqit, konstatohet se **vlera 18,010,183 lekë duhet të kontabilizoheshin në llog. 467 “Kreditorë të ndryshëm”** për detyrime të prapambetura ndaj të tretëve.

Kriteri

Përsa trajtuar më sipër, këto veprime janë në kundërshtim me, UMF nr.2 datë 06.02.2012 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit” pikën 62 dhe 102, me Udhëzimin nr.2 datë 09.01.2015, pika 6.1 “Vendimet gjyqësore”, me Udhëzim e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik” Pika 3.3/c.d “Trajtimi kontabël dhe funksioni i llogarive të të tretëve (klasa 4)”, me VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël” Kapitulli IV “Llogaritë e të tretëve, klasa 4” Seksioni I “Përbërja, klasifikimi dhe sqarime të përgjithshme” pika 2

Ndikimi/Efekti:

Detyrimet për vendime gjyqësore si rezultat i humbjeve të proceseve gjyqësore nga Bashkia Peqin, kanë sjellë rritjen e detyrimeve ndaj të tretëve si dhe pozicionimi gabim i këtyre detyrimeve ka sjellë paqartësi në klasifikimin e detyrimeve kreditore dhe vlerave të tyre me ndikim në realitetin e informacionit kontabël që ofrojnë PF për përdoruesit e interesuar të këtyre PF-ve.

Shkaku

- Nga Titullari dhe nga Drejtoria Juridike nuk janë marrë masat e nevojshme për zgjidhjen e konflikteve me palë të treta sipas dispozitave ligjore në fuqi, gjë që ka sjellë dhe humbjen e proceseve gjyqësore me të tretët, duke sjellë rritjen e detyrimeve. Nga Drejtoria Ekonomike

nuk janë kontabilizuar saktë në llogarinë përkatëse të klasës 4 detyrimet e konstatuara për Investime

Rëndësia:- I mesëm.

Rekomandimi

Drejtorja e financës në mbyllje të vitit ushtrimor 2021 të kryhen veprimet e sistemimit në kontabilitet që detyrimet ndaj të tretëve të lindura nga vendimet gjyqësore të formës së prerë të pashlyera dhe kontratat e investimeve në vlerën 18,010,183 leke të pasqyrohen në gjendjen kreditore të llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm” të pasivit të bilancit.

Analiza e llogarive debitorë viti. 2020

-Llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” për vlerën kontabël 33,114,538 lekë. Kjo llogari është krijuar gjatë vitit 2020 dhe përfaqëson vlerën kundërparti të disa llogarive të detyrimeve kreditore të pasivit të bilancit, e analizuar si vijon:

Analizë e llogaria 486			
Nr	R. Ditarit të veprimeve.	EMERTINI	Debi
1		Sig.Shoq&Shend	4275157
2		Tatim ne burim	111339
3		Shperblim KB	3161187
4		Paga Tetor	7333179
5		Paga nentor	6999955
6		Paga Dhjetor	11233721
	Gjendja 31.12.2020		33114538

Vlera debitorë e kësaj llogarie, ***nuk është e kuadruar*** me shumën e llogarive kreditore të pasivit të bilancit, vlera e të cilave është në shumën totale 82,854,723 lekë sipas llogarive dhe as është e analizuar sipas llojeve të detyrimeve të pa paguara si më poshtë vijon:

-Llogaritë 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” për vlerën kontabël për 30,134,750 lekë dhe llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm” për vlerën kontabël 36,483,176 lekë, ***në shkelje*** të kërkesave të UMF nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Kap. III, pika 42 dhe Aneksi –1, Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik.

Analiza e llogarive kreditore viti. 2020

Gjendja e llogarive kreditore, referuar pasqyrave financiare, është si më poshtë vijon:

-Llogaritë 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” është për vlerën kontabël 30,134,750 lekë. Nga analiza e kësaj e këtyre llogarive, sipas dokumentacionit që na u paraqit, konstatohet se detyrimet e pa paguara për llogaritë **401-408**, janë gjithsej në shumën **30,134,750 lekë** Detyrimi për shumën 30,134,750 është i analizuar nga Bashkia Peqin

Llogaria 42 “Detyrime ndaj personelit” për vlerën 26,290,063 lekë. Nga analiza e kësaj llogarie, konstatohet se janë përfshirë detyrimet e pa paguara për pagat e personelit të prapambetura për disa muaj për një pjesë të personelit, përfshi edhe muajin Dhjetor të fund vitit 2020. Vlerë e cila është e analizuar nga bashkia Peqin.

Llogaria 431 “Detyrimet ndaj shtetit për tatim taksat” për vlerën 677,405 lekë përfaqëson detyrimet e pa paguara për tatimin mbi të ardhurat personale.

Llogaria “435 “Sigurime Shoqërore” për vlerën 3,246,722 lekë përfaqëson detyrimet e pa paguara për sigurimet shoqërore.

Llogaria “436 “Sigurimet shëndetësore” për vlerën e detyrimeve 443,959 lekë.

Në analizë: Në formatin nr. 2 “Pasqyra e performancës financiare” paraqet llogaritë e të ardhurave dhe shpenzimeve me klasifikim sipas natyrës ekonomike të pasqyruara PF për vitin 2020 sipas zërave, paraqitet në pasqyrën aneks 2.1.3 bashkëlidhur Raport Auditimit.

Sipas kësaj pasqyre paraqiten llogaritë financimi nga buxheti i shtetit për vitin 2020 (grant) në shumën 598,603,236 lekë. Të ardhurat e realizuara nga kjo Njësi vendore në vlerën 41,428,918 lekë sipas aktit të rakordimit me Degën e Thesarit Peqin. **Përfshirja në këtë format të PF e gjendjes të të ardhurave sipas llogarive analitike është bërë nga jashtë sipas ditarit të azhornuat nga drejtoria e taksave e tarifave vendore.** Gjendja e secilës llogari të të ardhurave rakordon me vlerat e paraqitura në llogarite analitike të aktit të rakordimit me degën e thesarit Peqin.

Po kështu shumat e paraqitura në gjendjet e llogarive të shpenzimeve sipas natyrës të këtij formati rakordojnë me shumat e rezultuara në llogaritë e shpenzimeve sipas klasifikimit buxhetor në aktrakordimin e me degën e thesarit.

Pesha specifike e këtyre shpenzimeve të pasqyruara në këtë format si: Shpenzimet në llog. (600) “Paga, shpërblime e të tjera personeli” në vlerën 152,539,860 lekë; Shpenzimet në llog. (601) “Kontribute të sig. Shoqërore e shëndetësore” në vlerën 27,160,989 lekë shpenzimet në llog. (602) “Mallra shërbime të tjera” në vlerën 81,314,267 lekë të shpenzimeve; Shpenzimet në llog. (604) “Transferime korrente të brendshme” në vlerën 4,349,323lekë , Shpenzimet në llog. (606) “Transferta për buxhete familjare e individë” në vlerën 367,904,844 lekë.

Për vitin 2020 totali i të ardhurave në vlerë është 651,719,288 lek dhe totali shpenzimeve është 633,074,778 lek. Diferenca e tyre **në vlerën 18,644,510 lekë rakordon me gjendjen e llog.85 “Rezultatit e ushtrimit”**

Formati nr.6 “Investimet dhe burimet e financimit”

- Zëri "Burimet për investime" Formatin 6, i plotësuar për shumën 201,075,611 lekë në analizë tregon burimet e investimit, vlera prej 195,613,051 lekë fonde të akorduara nga qeveria për investime, vlera prej 5,462,560 lekë grante të brendshme kapitale.

Nr.	Nr. Referencë e llogarive	EMERTIMI	Teprica në fillim të vitit	Transaksionet e vitit		Teprica në fund të vitit
				Debi	Kredi	
a	b	c	d	e	f	g
1	I.	SHPENZIMET PER INVESTIME	129,966,176	79,730,697	10,652,400	199,044,473
2	230	Shpenzime për Aktive Afatgjata jo materiale	0	10,652,400	10,652,400	0
3	231	Shpenzime për Aktive Afatgjata materiale	129,966,176	69,078,297		199,044,473
4	25,26	Shpenzime për Aktive Afatgjata Financiare	0	0		0
5	25	Huadhënie dhe nenhuadhënie	0	0	0	0
6	26	Pjesëmarrje në kapitalin e vet	0	0	0	0
7	II.	BURIMET PER INVESTIME	129,966,176	201,075,611	131,997,314	199,044,473
8	105	1.Grante të brendshme kapitale	129,966,176	201,075,611	131,997,314	199,044,473
9	1050	Grante kapitale nga Buxheti	129,966,176	195,613,051	126,534,754	199,044,473
10	1051	Grante kapitale nga nivele të tjera	0	0	0	0
11	1052	Kontribute të të tremeve për investime	0	0	0	0
12	1059	Grante të brendshme kapitale në natyrë	0	5,462,560	5,462,560	0
13	106	2.Grante të huaja Kapitale	0	0	0	0
14	1060	Nga qeveri të huaja	0	0	0	0
15	1061	Nga institucione ndërkombëtare	0	0	0	0
16	1069	Grante të huaja në natyrë	0	0	0	0
17	14	3.Grante kapitale për investime për të treme	0	0	0	0
18	145	Grante brendsh. kapitale për pjesm. në invest. në të treme	0	0	0	0
19	146	Grante të huaja kapitale për pjesm. në invest. në të treme	0	0	0	0
20	11	4.Fonde të tjera të veta.	0	0	0	0
21	111	Fonde rezervë	0	0	0	0
22	115	Caktim fondi për investime nga rezultati I vitit	0	0	0	0
23	116	Të ardhura nga Shitja e aktiveve të qendrueshme	0	0	0	0

Nr.	Nr. Referencë e llogarive	EMERTIMI	Teprica ne fillim te vitit	Transaksionet e vitit		Teprica ne fund te vitit
				Debi	Kredi	
a	b	c	d	e	f	g
24	12	5.Rezultati I Mbartur	0	0	0	0
25	16,17	6.Huamarrje	0	0	0	0
26	16	Huamarrje e Brendshme	0	0	0	0
27	17	Huamarrje e Huaj	0	0	0	0
29	III.	BALANCA (II-I)				
30		(Burimet për Investime minus Shpenzimet për Investime)	0	121,344,914	121,344,914	0

- Zëri **“Burimet për Investime”** në formati 6 e plotësuar për shumën 201,075,611 lekë në analizë nuk rakordon me pasqyrën “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata” kolona 4 formati 7/b.

- Në pasiv të bilancit dhe në formatin 6 të “Pasqyra Investimet dhe burimet e financimit” nuk është plotësuar gjendja e kolonave në çelje dhe ne mbyllje.

Për shtesat e krijuara nga blerja e aktiveve nuk janë kryer veprimet kontabël: në debi të llog. 115 “Caktim nga rezultati i vitit për investime” në kredi të 1011 “Shtesa të fondit bazë”. Ndërsa për fatura të mbërritura për realizimin e investimeve, financimi i të cilave bëhet nëpërmjet transferimit të të ardhurave të krijuara në vitin ushtrimor për përdorim nga seksioni i funksionimit në seksionin e investimeve kreditohet llog.115 “Caktim fondi për investime nga rezultati i vitit” në debi të llog. 831 “Transferim për caktimin e të ardhurave për investime”.

Konkluzion:

Nga auditimi i pasqyrave financiare për vitet 2020 rezultoi se nuk ishin plotësuar *formati nr.5 i pyetësorëve dhe shënimeve shpjeguese* të pasqyrave financiare vjetore, të cilat përmbajnë informacion sqarues, përveç atij që paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar, pasqyrën e performancës, pasqyrën e flukseve monetare dhe pasqyrën e ndryshimit të aktiveve neto/fondeve neto. Shënimet japin përshkrime me fjalë apo zbërthime të zërave të paraqitur në këto pasqyra apo evidentojnë problemet që mund të kenë rezultuar gjatë fazës së përgatitjes apo të paraqitjes së pasqyrave financiare vjetore.

Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” nen/Kapitulli 3.7 “Rregullat për dhënien e shënimeve shpjeguese për pasqyrat financiare individuale”, pikat **83, 84, 85**.

Referuar SKK 2 “Paraqitja e Pasqyrave Financiare”/ “Shënimet shpjeguese”, shënimet shpjeguese japin një përshkrim ose zbërthim të mëtëjshëm të zërave të paraqitur në këto pasqyra, si dhe informacion mbi zërat që nuk plotësojnë kriteret për një paraqitje të veçantë në pasqyrat financiare. Në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare, një njësi ekonomike raportuese do të japë informacionin, duke u bazuar në konceptin e materialitetit, dhe zërat jomateriale mund të paraqiten të grupuar. Mbështetur në standardet e auditimit, por edhe në punën që grupi i KLSH-së, e ka vlerësuar materialiteti për Bashkinë Peqin 0.5% ndërkohë që në dijeni tonë nuk ka informacion se mbi c’bazë subjekti vlerëson materialiteti e zërave, më qëllim përfshirjen ose jo të tyre në relacionet shpjeguese, sipas kërkesave të diktura nga SKK 2.

Përsa trajtuar më sipër, këto veprime janë në kundërshtim me VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël” Kapitulli I, pika 1. UMF nr.26, datë 27.12.2007 “Për disa shtesa e ndryshime në UMF nr.14, datë 28.12.2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore 2007, për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësitë që varen prej tyre si dhe të njësitë të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donator të huaj”, Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave

financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 8 ,32,83, 84,85, me UMF nr. nr. 30 datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” kapitulli III, pika 28.

a) Paga, shpërblime e të tjera personeli (llog. 600) dhe sigurimet shoqërore (llog 601)

-Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicionit nga zyra e personelit dhe zyrës së financës në lidhje me zbatimin e dispozitave ligjore, që rregullojnë pagat dhe shpërblimet u konstatua se:

-Me vendimet e Këshillit të Bashkisë nr. 45 ,datë 23.12.2019 për vitin 2020, është miratuar struktura, organika dhe numri i punonjësve për funksionimin dhe ushtrimin e aktivitetit të administratës së Bashkisë Peqin dhe shërbimeve mbështetëse. të cilat janë paraqitur dhe konfirmuar brenda afateve ligjore nga Prefekti Qarkut Peqin.

-Organika për vitin 2020 është 293 punonjës, dhe gjendja civile 5 punonjës.

-Për të gjithë periudhën e audituar janë respektuar struktura dhe organika.

-Nga të punësuarit 27 janë të me statusin e nëpunësit civil, marrëdhëniet e punës e të cilëve rregullohen me ligjit nr.152/2013 datë 30.05.2013 “Për Nëpunësin Civil”, ndërsa 328 punonjës janë me kontratë pune paradhëniet e punës të të cilëve rregullohen me ligjin nr. 7961, date 12.07.1995 “Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar

-Përcaktimi i nivelit të pagave për vitin 2020 është bërë në përputhje me kërkesat e VKM Nr. 165, datë 2.3.2016 “Për grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar me VKM nr.177 datë 08.03.2017. Në hartimin e këtyre strukturave janë zbatuar kriteret e klasifikimit të vendeve të punës për organet e qeverisjes vendore në lidhjen nr.5, duke përshtatur dhe respektuar kufijtë e niveleve të pagave në përputhje me kategorinë e kësaj njësie vendore (50,001-100.000 mbas zbatimit të Reformës Territoriale).

Realizimi i fondit të pagave, sigurimeve shoqërore dhe numrit të punonjësve për Aparatin e Bashkisë, jepet nga pasqyra në vijim:

nr .	Emërtimi viti	Njësi matje	Viti 2020		
			P	R	%
1	Pagat (llog 600)	000 L	176472966	147722237	84
2	Sig. Shoq (Llog 601)	“	26712120	25,326,611	95

Nga pasqyra konstatohet se pagat dhe sigurimet shoqërore rezultojnë me mos realizim për vitin 2020, i cili është efekt kryesisht i mos plotësimit të strukturës organike.

- Është mbajtur dhe azhurnuar libri i pagave e ditari i pagave.

-Nga auditimi i listë-pagesave u konstatua se listë-pagesat hartoheshin sipas standarteve të kontabilitetit, ku plotësoheshin pagat me të gjithë elementet dhe shtesa të ndryshme të përfituara deri tek shuma bruto. Po kështu pasqyroheshin llojet e ndalesave deri tek paga neto. Përmbledhëset janë të kuadruar me listë pagesat dhe me urdhër pagesat respektive, të nënshkruara nga punonjësi i financës dhe titullari.

Në dokumentacionin justifikues të shpenzimeve për paga rezultoi se listëpagesat janë nënshkruar nga punonjësi caktuar për menaxhimin e burimeve njerëzore, në zbatim me UMF nr. 30 dt. 27.12.2011 “Për menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, pika 69.

IV. GJETJE DHE REKOMANDIME

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Në pasqyrat Financiare të fund vitit 2020, *disa llogari të aktivitetit, nuk pasqyrojnë saktë gjendjen debitorë* ose ka llogari të cilat janë të denatyrizuar pasi nuk duhej të ishin me saldo debitor ose duhej të ishin mbyllur në fund të vitit ushtrimor pasi janë llogari të përkohshme, konkretisht:

1.-Llogaria 486 “*Shpenzime të periudhave të ardhshme*” për vlerën kontabël 33,114,538 lekë. Kjo llogari është krijuar gjatë vitit 2020 dhe përfaqëson vlerën kundërparti të disa llogarive të detyrimeve kreditore të pasivit të bilancit, e analizuar si vijon: Sigurime Shoqërore e Shendetsores në vlerë 4,275,157 lekë, Tatim në burim në vlerë 11133 lekë, Shpërblim KB në vlerë 3,161,187 lekë, Paga Tetor në vlerë 7333179 lekë, Paga nëntor në vlerë 6999955 lekë dhe Paga Dhjetor në vlerë 11233721 lekë

Vlera debitorë e kësaj llogarie, *nuk është e kuadruar* me shumën e llogarive kreditore të pasivit të bilancit, vlera e të cilave është në shumën totale 82,854,723 lekë sipas llogarive dhe as është e analizuar sipas llojeve të detyrimeve të pa paguara si më poshtë vijon:

-Llogaritë 401-408 “*Furnitorë e llogari të lidhura me to*” për vlerën kontabël për 30,134,750 lekë dhe llogaria 467 “*Kreditorë të ndryshëm*” për vlerën kontabël 36,483,176 lekë.

2.-Në këtë rast, llogaria 520 “*Disponibilitete në Thesar*” e pa rakorduar me të dhënat e Degës së Thesarit, në pasqyrat financiare, nuk pasqyron saktë vlerën e saj në fund të vitit ushtrimor, pasqyruar më shumë në pasqyrat financiare për diferencën $32,832,865 - 32,823,070 = 9,795$ lekë,

3.-Po kështu llogaria 466 “*Kreditorë për mjetet në ruajtje*” në pasqyrat financiare është për vlerën kontabël 14,188,355 lekë. Sipas analizës së kësaj llogarie të rakorduar me degën e thesari, kjo llogari është për vlerën 14,174,863 lekë dhe është e analizuar sipas objekteve për 21 raste. Në këtë rast, *vlera kontabël e kësaj llogarie, nuk është pasqyruar saktë*, pasqyruar më shumë për diferencën $(14,188,355 - 14,174,863) = 13,492$ lekë.

1.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës, të marrë masat për sistemimin e llogarive të sipër cituara, bazuar në dokumentacionin ligjor e kontabël;

-Të bëjë sistemimin e llogarive kontabël përsa janë konstatuar diferenca më pak ose më shumë sesa aktet e rakordimet me Degën e Thesarit për gjendjen kontabël në fund të vitit ushtrimor 2020.

Brenda datës 31.12.2021

2. Gjetje nga auditimi: Në pasqyrat financiare *gjendja e llogarisë 466 “Kreditorë për mjetet në ruajtje” është për vlerën kontabël 14,188,355 lekë.* Sipas analizës së kësaj llogarie të rakorduar me degën e thesari, kjo llogari është për vlerën 14,174,863 lekë dhe është e analizuar sipas objekteve për 21 raste. Në këtë rast, *vlera kontabël e kësaj llogarie, nuk është pasqyruar saktë*, pasqyruar më shumë për diferencën $(14,188,355 - 14,174,863) = 13,492$ lekë.

Nga analiza e përmbajtjes së kësaj llogarie, konstatohet se për 15 subjekte në shumën 6,806,832 lekë gjenden në ngurtësuar fonde nga vitin 2019 për të cilat është përmbushur afati i garancisë dhe nuk është bërë çbllokimi i tyre. Drejtoria e Financës, nuk ka kryer asnjë veprim sipas kushteve të kontratës për çbllokimin e këtyre fondeve dhe përdorimin e tyre në buxhetin e vet. Përsa më sipër, nuk janë zbatuar kërkesat e UMF nr. 8, datë 9.03.2018 “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme*”, Kap. III, pikat 29, 30, 39, 50 dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2011 “*Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit*” i ndryshuar, Kap. II, pika 10.

2.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës, në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të saktësojnë subjektet dhe fondet për të cilat janë ngurtësuar si garanci për punimet e kryera për të cilat kanë humbur të drejtën e përfitimit të tyre ose që janë në kushtet e parashkrimit të së drejtës, në zbatim të kërkesave të pikës 10, Kap. II të UKM nr. 3, datë 15.02.2011 “*Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit*” i ndryshuar.

Drejtoria e Financës, për këto raste, të procedojë sipas kërkesave ligjore pranë Degës së Thesarit Peqin për rimarrjen e fondeve të ngurtësuar dhe përdorimin e tyre në interes publik.

Brenda datës 31.12.2021

3. Gjetje nga auditimi: Gjendja e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”, në fillim të vitit 2020 është në vlerën historike 16,483,985 lekë dhe në fund të vitit 2019 në vlerën historike 16,483,985 lekë. Gjendja e kësaj llogari është e pa ndryshuar, pasi Drejtoria e Financës nuk ka rakorduar me Drejtorin e taksave mbi gjendjen e debitorëve në mbyllje të pasqyrave financiare për vitin 2020. Nga analiza e kësaj llogarie konstatohet se në debi të saj janë kontabilizuar debitorët për tatim taksat lokale të subjekteve për shumën 15,453,375 lekë kurse diferenca për shumën 1,030,610 lekë është vlera debitorë e subjektit sipërmarrës të punimeve “*Leon Konstruksion*” shpk sipas rekomandimeve të KLSH-së nga auditimi i kaluar. Nga Drejtoria e Financës dhe Drejtoria Juridike e Bashkisë Peqin, *nuk është procedura sipas ligjit përfshi kërkesë padi në Gjykatë për arkëtimin e detyrimeve debitorë, në kundërshtim me kërkesat ligjore.* Sipas rakordimet me Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit nuk janë përfshirë gjambat e vendosura nga IMTV-ja, në vlerën 3,500,000 lekë e akumuluar në fund të vitit ushtrimor 2020, kjo shuma nuk rezultojnë e regjistruara në kontabilitet në llogarinë që debitohet në bilancin kontabël 468 “Debitorë të ndryshëm” dhe llogarinë që kreditohet në pasqyrën e performancës financiare “7115 “*Gjoba kamatëvonesa, sekuestrime dhe zhdëmtime*”. Pra kemi një nënvlerësim të llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” dhe llogarisë “7115 “*Gjoba kamatëvonesa, sekuestrime dhe zhdëmtime*” me 3,500,000 lekë për vitin 2020. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin 9228 datë 29.04.2004 “*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*” neni 5, 6, 7, 9 dhe 10, ligjin 10296 datë 08.07.2010 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*”, urdhrit nr.64 datë 22.07.2014 “*Për shpallje të Standarteve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuar*” dhe Standartit Kombëtar të Kontabilitetit nr.8 “*Të ardhurat*”, pika 8 e Standartit ku përcaktohet njohja fillestare e të ardhurës.

3.1. Rekomandimi Drejtoria Ekonomike në Bashkinë Peqin të mbajë evidencën kontabël për të ardhurat dhe të kryejë veprimet kontabël për evidentimin e debitorëve për taksat dhe tariffat në llog. 468 “Debitorë të ndryshëm”, në mënyrë që përfshirja e të ardhurave në pasqyrat financiare të mos bëhet nga jashtë port ë ndjekë logjikën kontabël, duke i pozicionuar saktë në llogaritë përkatëse me qëllim që PF të ofrojnë një informacion të saktë mbi të drejta dhe detyrimet e të tretëve ndaj shtetit për taksa dhe tarifa vendore.

3.2. Rekomandimi: Drejtoria e Financës, në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, të marrë masat e nevojshme për arkëtimin e vlerave debitorë të krijuar në vite duke procedura me kërkesë padi në Gjykatë, në zbatim të kërkesave ligjore si dhe kontabilizimin e gjobave të vendosura nga IMTV-ja në fund të vitit 2020 në vlerën **3,500,000 lekë**

Brenda datës 31.12.2021

4. Gjetje nga auditimi: Gjendja e llogarisë 202 “*Studime dhe Kërkime*” paraqitet në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 15,524,250 lekë. Vlera e mbetur në fund të vitit 2020 prej 15,524,250 lekë e aktiveve afatgjata jo materiale e paraqitur në gjendjen e llogarisë 202 “*Studime dhe Kërkime*”, për 18 projekt-studime për investime të kryera nuk është shpërndarë sipas llojit të aktiveve materiale, ku janë kryer investimet, pavarësisht se punimet kanë përfunduar në vitet e mëparshme. Në fakt këto shpenzime për projektimin e një investimi të kryer për krijimin apo rikonstruksionet e aktiveve afatgjata materiale ose AQT nuk duhet të kontabilizohet në

llogarinë 202 “Studime dhe kërkime” pasi këto janë pjesë e kostos së AQT dhe nuk janë shpenzimet për kërkime të aplikuara dhe të zhvillimit. Për këtë vlerë ekziston inventar kontabël dhe fizik dhe ruajtja e tyre është bërë në arkiv në çdo dosje teknike të tenderave sipas investimit të kryer në aktivet materiale afatgjatë. Përsa trajtuar më sipër, këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzim e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik” Pika 2. Klasa 2, “Aktivet afatgjata” (përbërja dhe trajtimi kontabël), me VKM nr 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standarteve dhe rregullave kontabël”, Seksioni II “Aktivet e Qëndrueshme Patrupëzuar” Pika 1/b “Klasifikimi kontabël” e cila ndër të tjera përcakton se: “Shpenzimet e kërkimeve të aplikuara dhe të zhvillimit - Llogaria 202”.

4.2. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike në Bashkinë Peqin të kryejë veprimet e sistemimit në kontabilitet për shpërndarjen e vlerës së studim-projektiveve sipas investimeve të kryera dhe për çdo lloj aktiv afatgjatë material si pjesë e kostos së tij, duke kredituar llog. 202 “Studime dhe Kërkime” dhe debituar llogaritë përkatëse të klasës 21 për vlerat e mbetura koresponduese, në mënyrë që aktivet sipas llojit të paraqiten në vlerë të plotë.

Brenda datës 31.12.2021

5. Gjetje nga auditimi: Gjendja kontabël e aktiveve afatgjata materiale (në vlerën bruto) për vitin 2020 në vlerën 3,416,476,817 lekë dhe për vitin 2019 në vlerën 3,322,706,852 lekë është paraqitur i plotë, pasi janë pasqyruar të gjitha shtesat dhe pakësimet për çdo lloj grup aktiv. Inventari kontabël i aktiveve materiale gjendje në llogaritë: 210 “Toka, Troje, Terrene” është në vlerën 5,612,083 lekë; 211 “Pyje, Plantacione” në vlerën 13,928,877 lekë, 212 “Ndërtesa Konstruksione” në vlerën 656,054,662 lekë; 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” në vlerën 2,604,675,358 lekë; 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” në vlerën 24,596,832 lekë nuk është i qartë në përcaktimet e emërtesave dhe vlerave të secilit aktiv artikull për artikull. Në Dega e Thesarit Peqin nuk është kërkuar regjistri aktiveve për regjistrimin në sistemin informatikë financiar të qeverisë (SIFQ). Pra nuk ka një data basë me të dhënat aktiv për aktiv vetëm për Bashkinë Peqin, pra duke mos u kryer procesi i informatizimit të tyre. Kjo mënyrë evidentimi dhe proces inventarizimi, nuk jep informacion të saktë kontabël për çdo aktiv, duke mos “certifikuar” vlerat tek për tek të aktiveve, për të ofruar siguri të arsyeshme rreth vlerës fizike dhe kontabël të tyre, të njohura dhe regjistruara në pasqyrat financiare të njësisë. Këto veprime janë në kundërshtim me ne kundërshtim me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” kapitulli III, pika.

5.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike në Bashkinë Peqin të kryejë veprimet për krijimin dhe mbajtjen e një regjistri analitik aktivesh sipas formatit, ku duhet të përmbajë: datën e hyrjes ose marrjen në dorëzim, përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vendodhje, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, datën e daljes nga pronësia, në formë analitike.

Brenda datës 31.12.2021

6. Gjetje nga auditimi: Nga Bashkia Peqin, nuk janë kryer procedurat për inventarizimin e të gjitha aktiveve afat gjata jo materiale dhe materiale të investuara në vite nga Bashkia Peqin dhe ato që me miratim të Këshillit të Ministrave, kanë kaluar në pronësi të kësaj bashkie, konkretisht për llogaritë (me kostot historike):

Llogaria 202 “Studime dhe kërkime” për 21,730,200 lekë.

Llogaria 210 “Toka, troje, terrene” për 5,612,083 lekë.

Llogaria 211 “Pyje kullota plantacione” për 13,928,877 lekë.

Llogaria 212 “Ndërtim konstruksione” për 656,054,622 lekë.

Llogaria 213 “Rrugë rrjete vepra ujore” për 2,604,675,358 lekë.

Llogaria 214 “Instalime teknike, makineri pajisje, vegla pune” për 24,596,832 lekë.

Llogaria 215 “Mjete transporti” për 30,210,580 lekë.

-Nuk është përgatitur regjistri i pronave.

-Nuk është bërë regjistrimi i aktiveve në pronësi të Bashkisë.

Përsa më sipër, mosveprimet janë në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, Kap. III, neni 9, pika 1.2 - Të drejtën dhe përgjegjësinë e pronësisë; Kap. VII, neni 23, pika 14 –Planifikimin, administrimin, zhvillimin dhe kontrollin e territorit, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj , UMF nr. 30, datë 27.12.2011“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar pikat 26, 27, 30 dhe 74, dhe UMF nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”. Kap III- Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në Njësitë e Qeverisjes së përgjithshme, pika .

6.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë, të marrë masat që me specialistë të fushës, të inventarizojë dhe saktësojë pronat sipas të dhënave të kontabilitetit, regjistrimin e pronave në pronësi të vet, të kaluara me VKM-të përkatëse, si dhe për krijimin e regjistrit të pronave, në zbatim të kërkesave të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar dhe ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

7. Gjetje nga auditimi: Llogaria 4342 “Të tjera operacione me shtetin (debitor datë 31.12.2020)” në aktiv të pasqyrave financiare (Formati nr.1), paraqitet në vlerën 0 lekë pozicionimi i kësaj llogarie është bërë në mënyrë të gabuar. Pasi kjo llogari përbëhet nga detyrimet afatshkurtra për muajin dhjetor 2019 të cilat trashëgohen në vitin 2020, e cila në analizë përfshin gjendjet e llogarive në pasivin e bilancit: llog.401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” për vlerën 30,134,750 lekë, llog.42 “Detyrime ndaj personelit” për vlerën 26,290,063 lekë, llog.431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa” për vlerën 677,405 lekë, llog.435 “Sigurime shoqërore” për vlerën 3,246,772 lekë, llog. 436 “Sigurime shëndetësore” për vlerën 443,959 lekë Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 6, neni 10 dhe 11, të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, ligjin nr. 25/2018 datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 32 e tij.

7.1.Rekomandime: Bashkia Peqin, nëpërmjet Nëpunësit Zbatues, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet të llogarisë 4342 Operacione me shtetin” dhe kundër partisë 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” për shumën 60,792,949 lekë për vitin 2020 Veprimet e sistemuese të bëhen me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2021.

Brenda datës 31.12.2021

8. Gjetje nga auditimi: Llogarisë 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” paraqitet në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 30,134,750 lekë, dhe në mbyllje të vitit 2019 në vlerën 10,511,789 lekë, ku diferenca prej 19,622,961 lekë përfaqëson detyrimeve ndaj të tretëve për fatura të palikujduara gjatë vitit ushtrimor 2020. Sipas analizës së gjendjes së kësaj llogarie rezulton se ajo përbëhet nga 7 fatura të palikujduara të krijuara gjatë vitit 2020 për mallra dhe shërbime në vlerën 1,235,440 lekë dhe nga 18 raste detyrimesh për investime në vlerën 12,898,165 lekë, Nga analiza e kësaj e këtyre llogarive, sipas dokumentacionit që na u

paraqit, konstatohet se vlera 18,010,183 lekë duhet të kontabilizoheshin në llog. 467 “Kreditorë të ndryshëm” për detyrime të prapambetura ndaj të tretëve. Këto veprime janë në kundërshtim me, UMF nr.2 datë 06.02.2012 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit” pikën 62 dhe 102, me Udhëzimin nr.2 datë 09.01.2015, pika 6.1 “Vendimet gjyqësore”, me Udhëzim e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik” Pika 3.3/c.d “Trajtimi kontabël dhe funksioni i llogarive të të tretëve (klasa 4)”, me VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël” Kapitulli IV “Llogaritë e të tretëve, klasa 4” Seksioni I “Përbërja, klasifikimi dhe sqarime të përgjithshme” pika 2.

8.1. Rekomandimi: Drejtoria e financës në mbyllje të vitit ushtrimor 2021 të kryhen veprimet e sistemit në kontabilitet që detyrimet ndaj të tretëve të lindura nga vendimet gjyqësore të formës së prerë të pashlyera dhe kontratat e investimeve në vlerën 18,010,183 leke të pasqyrohen në gjendjen kreditore të llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm” të pasivit të bilancit.

Brenda datës 31.12.2021.

B. MASA ADMINISTRATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Pasqyrat financiare të vitit 2020 (bilanci), janë mbyllur jashtë afatit ligjorë, konfirmuar me shkresën nr. 64 prot, datë 16.04.2021, që Bashkia Peqin ka paraqitur të konfirmuar nga Dega e Thesarit Peqin, përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2020 me anekset përkatëse, pra me 1 muaj vonesë, Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me shkronjën (d) e pikës 4 e nenit 9, dhe shkronjës (b) e pikës 2 të nenit 12, të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollit”; UMF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësine e Qeverisjes së Përgjithshme”, pika 118.

1.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë, të analizojë shkaqet e mos mbylljes në afat të pasqyrave financiare të vitit 2020, duke evidentuar personat përgjegjës dhe të marrë masë ndaj tyre në zbatim të shkronjës (e) të nenit 71-*Kundërvajtje administrative*, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në R.SH”, ndryshuar me ligjin nr. 114/2012/datë 07.12.2012 dhe ligjin nr.57/2016, datë 2.6.2016.

- Në pasqyrat financiare të përshkruhet qartë baza mbi të cilën janë përgatitur, duke referuar aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për klasifikimin dhe raportimin e pasqyrave financiare. Përgjegjësia për raportim në çdo kohë të jetë e dokumentuar jo nëpërmjet shkresës përcjellëse të dërgimit të pasqyrave, por evidentohet në përgjegjësi të plotë në kapakun e pasqyrave financiare, se kush janë hartuesit dhe drejtuesit.

Menjëherë

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Auditimi Tematik.

KONTROLI I LARTË I SHTETIT